LIGJ
Nr. 80/2026

PËR KËRKESAT E TRANSPARENCËS PËR EMETUESIT E TITUJVE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton kërkesat për publikimin e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm për emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar që ndodhet ose që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë apo brenda një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.

2. Kërkesat e këtij ligji nuk zbatohen për kuotat e emetuara nga sipërmarrjet e investimeve kolektive, të ndryshme nga ato me pjesëmarrje të mbyllur ose për kuotat që janë blerë, ose janë shitur në sipërmarrje të tilla investimi kolektiv.

---

[1] *Ky ligj është përafruar plotësisht, me:*
- direktivën 2004/109/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, "Për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar", dhe që ndryshon direktivën 2001/34/EC;
- direktivën 2007/14/EC e Komisionit, datë 8 mars 2007, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e disa dispozitave të direktivës 2004/109/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, 'Për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar'";
- direktivën 2008/22/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2008, "Për ndryshimin e direktivës 2004/109/EC për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, sa i përket kompetencave zbatuese të dhëna Komisionit";
- direktivën 2010/73/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 nëntor 2010, që ndryshon direktivat 98/26/EC, 2002/87/EC, 2003/6/EC, 2003/41/EC, 2003/71/EC, 2004/39/EC, 2004/109/EC, 2005/60/EC, 2006/48/EC, 2006/49/EC dhe 2009/65/EC, në lidhje me kompetencat e Autoritetit Evropian Mbikëqyrës;
- direktivën 2013/50/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 22 tetor 2013, "Për ndryshimin e direktivës 2004/109/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, të direktivës 2003/71/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për prospektin që duhet të publikohet kur ofrohen ose pranohen për tregtim tituj dhe të direktivës 2007/14/EC të Komisionit, që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e disa dispozitave të direktivës 2004/109/EC";
- rregulloren e deleguar e Komisionit (BE) 2015/761, datë 17 dhjetor 2014, që plotëson direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me disa standarde teknike rregullatore për zotërimet e mëdha;
- rregulloren (BE) 2021/337 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2021, për ndryshimin e rregullores (BE) 2017/1129, në lidhje me prospektin e rimëkëmbjes së BE-së dhe përshtatjet e synuara për ndërmjetësit financiarë, si dhe të direktivës 2004/109/EC, në lidhje me përdorimin e formatit të vetëm elektronik për raportet vjetore financiare, për të mbështetur rimëkëmbjen nga kriza COVID-19;
- direktivën (BE) 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 537/2014, direktivën 2004/109/EC, direktivën 2006/43/EC dhe direktivën 2013/34/BE, në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave;
- direktivën (BE) 2023/2864 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2023, për ndryshimin e disa direktivave, në lidhje me krijimin dhe funksionimin e pikës së vetme të aksesit evropian (ESAP).

3. Dispozitat e përmendura në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 26 të këtij ligji, nuk zbatohen për titujt që pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, të emetuar nga Republika e Shqipërisë, nga një shtet anëtar i BE-së ose nga organet e tyre të qeverisjes vendore e rajonale.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për emetuesin për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës, si dhe nga një emetues, titujt e të cilit janë pranuar për tregtim vetëm në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Tituj**" janë titujt e transferueshëm siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, i cili transpozon legjislacionin e Bashkimit Evropian për tregjet e instrumenteve financiare, me përjashtim të instrumenteve të tregut të parasë, që kanë një maturitet më pak se 12 muaj;

b) "**Tituj borxhi**" janë obligacionet ose forma të tjera të borxheve, të titulluara të transferueshme, me përjashtim të titujve që janë ekuivalentë me aksionet në shoqëri ose të cilat, nëse konvertohen, ose nëse ushtrohen të drejtat e dhëna prej tyre, krijojnë një të drejtë për të blerë aksione ose tituj ekuivalentë me aksionet;

c) "**Autoriteti**" është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

ç) "**Treg i rregulluar**" është tregu siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, i cili transpozon legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian për tregjet e instrumenteve financiare;

d) "**Emetues**" është një person fizik ose juridik, i rregulluar nga e drejta private ose publike, përfshirë një shtet titujt e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

Në rastin e certifikatave të depozitave, të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar, emetues është emetuesi i titujve të përfaqësuar, pavarësisht nëse këta tituj janë pranuar apo jo për tregtim në një treg të rregulluar;

dh) "**Aksionar**" është çdo person fizik ose juridik, i cili zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi:

i. aksionet e një emetuesi në emër të vet dhe për llogari të vet;

ii. aksionet e një emetuesi në emër të vet, por për llogari të një personi tjetër fizik ose juridik;

iii. certifikata depozitash, rast në të cilin mbajtësi i dëftesës së depozitarit duhet të konsiderohet si aksionar për aksionet bazë, që përfaqësohen përmes certifikatave të depozitave;

e) "**Shoqëri e kontrolluar**" është çdo shoqëri, për të cilën:

i. një person fizik ose juridik zotëron shumicën e të drejtave të votës; ose

ii. një person fizik ose juridik ka të drejtën për të emëruar ose për të shkarkuar një pjesë të madhe të anëtarëve të organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës dhe është në të njëjtën kohë aksionar, ose anëtar i shoqërisë në fjalë; ose

iii. një person fizik ose juridik është aksionar ose anëtar dhe, në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar me aksionarë, ose anëtarë të tjerë të shoqërisë në fjalë, kontrollon i vetëm të drejtat e votës së një pjese të madhe të aksionarëve apo të anëtarëve; ose

iv. një person fizik ose juridik ka kompetencat për të ushtruar apo ushtron aktualisht një ndikim dominues ose kontroll;

ë) "**Sipërmarrje e investimeve kolektive, e ndryshme nga ato me pjesëmarrje të mbyllur**" është fondi i investimit dhe shoqëria e investimit:

i. objekti i të cilit është investimi kolektiv i kapitalit të ofruar nga publiku, që vepron mbi parimin e shpërndarjes së rrezikut;

ii. kuotat e të cilit, me kërkesë të mbajtësit të tyre, blihen apo shlyhen drejtpërdrejt apo tërthorazi nga aktivet e këtyre sipërmarrjeve.

f) "**Kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive**" janë titujt e emetuar nga një sipërmarrje e investimeve kolektive dhe përfaqësojnë të drejtat e pjesëmarrësve për aktivet e një sipërmarrjeje të tillë;

g) "**Shtet i origjinës**":

i. për emetuesin e titujve të borxhit, vlera nominale për njësi e të cilave është më e vogël se ekuivalenti në lekë i 1000 eurove apo për emetuesin e aksioneve:

- kur emetuesi është themeluar në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian është Republika e Shqipërisë apo shteti anëtar i Bashkimit Evropian (në vijim shteti anëtar) në të cilin emetuesi ka selinë e regjistruar;

- kur emetuesi është themeluar në një vend të tretë është Republika e Shqipërisë ose shteti anëtar i Bashkimit Evropian, i zgjedhur nga emetuesi ndërmjet vendeve anëtare, ku titujt e tij janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Zgjedhja e shtetit anëtar të origjinës mbetet e vlefshme nëse emetuesi nuk ka zgjedhur një shtet të ri anëtar të origjinës, sipas nënndarjes "iii" të kësaj shkronje dhe ka bërë publike zgjedhjen, në përputhje me nënndarjen "iv" të kësaj shkronje.

Përkufizimi "shteti i origjinës" zbatohet për titujt e borxhit të denominuar në valutë të ndryshme nga euro, me kusht që vlera nominale për njësi në datën e emetimit të jetë më pak se ekuivalenti në lekë i 1000 eurove përveçse kur kjo vlerë është afërsisht ekuivalenti në lekë i 1000 eurove;

ii. për çdo emetues që nuk parashikohet në nëndarjen "i" të kësaj shkronje, shteti anëtar i përzgjedhur nga emetuesi ndërmjet shtetit anëtar në të cilin emetuesi ka selinë e tij të regjistrimit, kur është e aplikueshme, dhe atyre shteteve anëtare ku titujt e tij janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Emetuesi mund të zgjedhë vetëm një shtet anëtar si shtetin e tij të origjinës. Zgjedhja e tij mbetet e vlefshme të paktën 3 vjet nëse titujt e tij nuk janë më të pranuar për tregtim në ndonjë treg të rregulluar në Bashkimin Evropian ose nëse emetuesi nuk mbulohet nga nënndarjet "i" ose "iii", të kësaj shkronje, gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare;

iii. për një emetues titujt e të cilit nuk janë më të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në shtetin e tij të origjinës, siç përcaktohet në paragrafin e dytë, të nëndarjes "i" ose nënndarjen "ii", të kësaj shkronje, por janë të pranuar për tregtim në një ose më shumë shtete të tjera anëtare, shteti i ri i origjinës është shteti anëtar i Bashkimit Evropian, që emetuesi mund të përzgjedhë ndërmjet shteteve anëtare, ku titujt e tij janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe, kur është e aplikueshme, shteti anëtar ku emetuesi ka selinë e regjistruar;

iv. një emetues bën publik shtetin e tij të origjinës, siç referohet në nënndarjet "i", "ii" ose "iii", të kësaj shkronje, në përputhje me nenet 28 dhe 29 të këtij ligji. Përveç kësaj, një emetues ia bën të ditur shtetin e tij të origjinës autoritetit, si autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë ose autoritetit kompetent të shtetit anëtar, ku ka selinë e regjistruar, kur është e aplikueshme, tek autoriteti kompetent i shtetit të origjinës dhe tek autoritetet kompetente të të gjitha shteteve anëtare pritëse.

Në mungesë të bërjes publike nga emetuesi të shtetit të tij të origjinës, siç përcaktohet në paragrafin e dytë, të nënndarjeve "i" ose "ii" të kësaj shkronje, brenda një periudhe prej tre muajsh nga data kur titujt e emetuesit pranohen për herë të parë për tregtim në një treg të rregulluar, shteti i origjinës do të jetë Republika e Shqipërisë ose shteti anëtar ku titujt e emetuesit pranohen për tregtim në një treg të rregulluar. Kur titujt e emetuesit pranohen për tregtim në tregje të rregulluara, që ndodhen ose veprojnë në Republikën e Shqipërisë, dhe brenda më shumë se një shteti anëtar, Republika e Shqipërisë dhe këto shtete anëtare konsiderohen shtete të origjinës të emetuesit derisa të bëhet publike nga emetuesi zgjedhja e mëvonshme e një shteti të vetëm të origjinës.

Për qëllim të këtij ligji, Republika e Shqipërisë trajtohet si "shtet i origjinës" ose "shtet pritës", sipas rastit, në kuptim të përkufizimit të këtij neni, pavarësisht statusit të saj si vend joanëtar i Bashkimit Evropian;

gj) "**Shteti pritës**" është Republika e Shqipërisë ose një shtet anëtar i Bashkimit Evropian (në vijim shteti anëtar), ku titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, nëse është i ndryshëm nga shteti i origjinës;

h) "**Informacion i rregulluar**" është i gjithë informacioni që emetuesi ose çdo person tjetër që ka paraqitur kërkesë për pranim të instrumenteve financiare për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, është i detyruar ta bëjë publik në përputhje me këtë ligj, si dhe informacioni që duhet bërë publik sipas legjislacionit në fuqi për abuzimin në treg (manipulimin e tregut dhe përdorimin e informacionit të brendshëm) dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

i) "**Mjete elektronike**" janë mjetet elektronike të përdorura për përpunimin (përfshirë kompresimin digjital), ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave, duke përdorur kabllo, radio, teknologji optike ose çdo mjet tjetër elektromagnetik;

j) “**Shoqëri administruese**” është shoqëria sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive, që transpozon të drejtën evropiane, që lidhet me sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (UCITS);

k) “**Krijues tregu**” është personi, i cili në mënyrë të vazhdueshme është i pranishëm në tregjet financiare si person i gatshëm të tregtojë për llogari të vet, me fondet e veta, duke blerë dhe duke shitur instrumente financiare kundrejt aktiveve të veta, me çmime që i përcakton vetë;

l) “**Institucion krediti**” është shoqëria sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe transpozon legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian në këtë fushë;

ll) “**Tituj të emetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur**” janë tituj borxhi në dispozicion, të emetuar nga i njëjti emetues ose të paktën dy emetime të veçanta titujsh që janë të ngjashme në lloj dhe/ose klasë;

m) “**Marrëveshje formale**” është një marrëveshje detyruese sipas legjislacionit në fuqi;

n) “**Raportimi i qëndrueshmërisë**” është raportimi sipas përcaktimeve në legjislacionin që rregullon kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

nj) “**Ekuivalenti në lekë i shumës në euro**” është vlera në lekë e shumës përkatëse në euro, e llogaritur sipas kursit zyrtar të këmbimit, të publikuar nga Banka e Shqipërisë një ditë përpara datës së referencës.

2. Për qëllim të përkufizimit të termit “shoqëri e kontrolluar”, e parashikuar në nënndarjen “ii”, të shkronjës “e”, të pikës 1 të këtij neni, të drejtat e zotëruesit në lidhje me votën, emërimin dhe shkarkimin përfshijnë të drejtat e çdo shoqërie tjetër të kontrolluar nga aksionari dhe ato të çdo personi fizik ose juridik që vepron, pavarësisht se në emër të tij, për llogari të aksionarit ose çdo shoqërie tjetër të kontrolluar nga ky i fundit.

3. Çdo referencë për personat juridikë në këtë ligj do të përfshijë edhe shoqatat e regjistruara të biznesit pa personalitet juridik dhe personat që veprojnë në emër të të tjerëve (*trust*-et).

Neni 3
Kalendari i ditëve të tregtimit

1. Ditë tregtimi janë ditët e tregtimit të tregut të rregulluar të shtetit të origjinës së emetuesit, në kuptim të pikave 2 dhe 6, të nenit 15, si dhe të pikës 1, të nenit 22 të këtij ligji.

2. Autoriteti publikon në faqen zyrtare kalendarin e ditëve të tregtimit të çdo tregu të rregulluar, që ndodhet ose ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II
INFORMACIONI PERIODIK

Neni 4
Raportet financiare vjetore

1. Emetuesi publikon raportin financiar vjetor jo më vonë se 4 muaj nga mbyllja e çdo viti financiar dhe sigurohet që ai të jetë i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet.

2. Raporti financiar vjetor duhet të përfshijë:

a) pasqyrat financiare të audituara, individuale apo të konsoliduara, sipas rastit;

b) raportin e drejtimit të brendshëm, si pjesë përbërëse e raportit të ecurisë së veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

c) deklaratat e dhëna nga personat përgjegjës të emetuesit, ku jepen qartë emrat dhe funksionet e tyre, sipas të cilave, për aq sa kanë dijeni, pasqyrat e përgatitura financiare, në përputhje me setin e standardeve të zbatueshme të kontabilitetit, të paraqesin një pamje të vërtetë e të drejtë të aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar të fitimit e të humbjes së emetuesit dhe shoqërive të përfshira në konsolidim, të marra si një e tërë. Deklaratat duhet të konfirmojnë se raporti i drejtimit të brendshëm përmban një pasqyrë të drejtë të zhvillimit e të ecurisë së aktivitetit dhe pozicionit të emetuesit e të

shoqërive, të përfshira në konsolidim, të marra si një e tërë, së bashku me përshkrimin e rreziqeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballen, dhe kur është e përshtatshme, se ky raport është përgatitur në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të përmendura në legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Kur emetuesi është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të audituara përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara, të përgatitura në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë mëmë, të përgatitura në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë apo të shtetit anëtar ku është themeluar shoqëria mëmë.

4. Kur emetuesi nuk është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të audituara përfshijnë pasqyrat e përgatitura në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë apo të shtetit anëtar ku është themeluar shoqëria.

5. Auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore të emetuesit kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

6. Audituesi ligjor përgatit një opinion dhe deklaratë për raportin e drejtimit të brendshëm, sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

7. Së bashku me raportin financiar vjetor, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, emetuesi publikon raportin e plotë të auditimit, të nënshkruar nga audituesi ligjor ose nga shoqëria audituese nëpërmjet audituesit ligjor, që kryen auditimin në emër të saj, si persona përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të emetuesit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor. Raporti i auditimit publikohet sipas mënyrës dhe afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

8. Në rastet kur emetuesi ka detyrim të raportojë për qëndrueshmërinë, në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, ai duhet të marrë opinionin e audituesit ligjor për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

9. Së bashku me raportin financiar vjetor, emetuesi publikon të plotë raportin për dhënien e sigurisë për raportin e qëndrueshmërisë sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

10. Kur emetuesi është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, raporti i konsoliduar i drejtimit të brendshëm përgatitet sipas parashikimeve të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe dispozitave në fuqi për taksonominë, kur hartohen nga shoqëri për të cilat zbatohen këto dispozita.

11. Në rastet kur emetuesi nuk është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, raporti i drejtimit të brendshëm përgatitet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, kur ai hartohet nga shoqëritë për të cilat zbatohen këto dispozita.

12. Për vitet financiare pas datës 1 janar 2028, të gjitha raportet financiare vjetore do të përgatiten, do të depozitohen dhe do të publikohen në një format unik elektronik raportimi pa cenuar kompetencat e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për përcaktimin e formateve kontabël të pasqyrave financiare dhe pa ndryshuar kërkesat e standardeve të zbatueshme të kontabilitetit.

13. Formati elektronik i raportimit, i parashikuar në pikën 12 të këtij neni, duhet të jetë në përputhje me standardet teknike rregullatore të miratuara nga Autoriteti për specifikimin e një formati unik elektronik të raportimit, që transpozon plotësisht rregulloren e deleguar (BE) 2018/815.

Neni 5

Raportet financiare 6-mujore

1. Emetuesi i aksioneve ose titujve të borxhit publikon një raport që mbulon gjashtëmujorin e parë të vitit financiar, sa më shpejt të jetë e mundur, pas përfundimit të periudhës përkatëse, por jo më vonë 3 muaj nga përfundimi i kësaj periudhe. Emetuesi sigurohet që raporti 6-mujor të mbetet publik për të paktën 10 vjet.

2. Raporti 6-mujor financiar përfshin:

a) setin e pasqyrave të përmbledhura financiare, individuale apo të konsoliduara, sipas rastit;

b) raportin e ndërmjetëm të drejtimit të brendshëm, si pjesë përbërëse e raportit të ecurisë së veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

c) deklaratat e dhëna nga personat përgjegjës të emetuesit, ku jepen qartë emrat dhe funksionet e tyre, në mënyrë që, për aq sa janë në dijeni, seti i pasqyrave të përmbledhura financiare të hartuara në përputhje me standardet përkatëse të kontabilitetit të paraqesë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar dhe fitimeve ose humbjeve të emetuesit apo të shoqërive të përfshira në këtë përmbledhje të konsoliduar në tërësi, sipas parashikimit në pikat 3 dhe 4 të këtij neni. Raporti i ndërmjetëm i drejtimit të brendshëm duhet të përmbajë një pasqyrë të drejtë të informacionit, sipas parashikimit në pikën 5 të këtij neni.

3. Në rastet kur emetuesi kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, seti i përmbledhur i pasqyrave financiare duhet të përgatitet në përputhje me standardin ndërkombëtar të kontabilitetit, që zbatohet për raportimin financiar të ndërmjetëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

4. Në rastet kur emetuesi nuk kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, pasqyrat e përmbledhura financiare duhet të përmbajnë të paktën një përmbledhje të bilancit, një pasqyrë të përmbledhur të fitimit dhe të humbjeve dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave. Për përgatitjen e bilancit dhe pasqyrës së fitimit dhe të humbjeve, emetuesi zbaton të njëjtat parime si gjatë përgatitjes së raporteve financiare vjetore.

5. Raporti i ndërmjetëm i drejtimit të brendshëm përfshin të paktën një përshkrim të ngjarjeve të rëndësishme, që kanë ndodhur gjatë 6 muajve të parë të vitit financiar dhe ndikimin e tyre në pasqyrat e përmbledhura financiare, së bashku me përshkrimin e rreziqeve dhe pasigurive kryesore për 6 muajt e mbetur të vitit financiar. Për emetuesit e aksioneve, raporti i ndërmjetëm i drejtimit të brendshëm duhet të përfshijë edhe transaksionet e rëndësishme me palët e lidhura.

6. Nëse raporti financiar 6-mujor është audituar, raporti i auditimit duhet të paraqitet i plotë. E njëjta gjë vlen edhe në rastin e rishikimit nga audituesit, të kryer sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. Në rast se raporti financiar 6-mujor nuk është audituar apo nuk është rishikuar nga audituesit, emetuesi bën një deklaratë në raportin e tij.

Neni 6

Përmbajtja minimale e pasqyrave financiare 6-mujore individuale jo të konsoliduara

1. Përmbajtja minimale e setit të pasqyrave financiare, të përmbledhura 6-mujore, në rastet kur këto pasqyra nuk janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), të miratuara nga organi kompetent i Republikës së Shqipërisë, duke marrë parasysh procedurën e miratimit të standardeve, sipas rregullores (KE) nr. 1606/2002 të Bashkimit Evropian, duhet të jetë në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Bilanci dhe pasqyra e përmbledhur e të ardhurave duhet të përfshijnë të gjithë titujt dhe nëntotalet e përfshira në pasqyrat financiare vjetore më të fundit të emetuesit. Zëra shtesë përfshihen në rastet kur mungesa e tyre do të sillte një paraqitje të pasaktë ose të paplotë të aktiveve, detyrimeve, pozicionit financiar dhe fitimit apo humbjeve të emetuesit.

3. Pasqyrat financiare 6-mujore përfshijnë edhe informacionin krahasues, si më poshtë:

a) bilancin në datën e mbylljes së periudhës së parë 6-mujore të vitit financiar aktual, si dhe bilancin krahasues në datën e mbylljes së vitit financiar paraardhës;

b) pasqyrën e të ardhurave për 6-mujorin e parë të vitit financiar aktual dhe pasqyrën krahasuese për periudhën përkatëse të vitit financiar të mëparshëm.

4. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 6-mujore, përfshijnë:

a) informacion të mjaftueshëm për të siguruar krahasueshmërinë midis pasqyrave financiare të përmbledhura 6-mujore dhe pasqyrave financiare vjetore;

b) informacion dhe shpjegime të mjaftueshme për të mundësuar kuptimin e plotë nga ana e përdoruesit të ndryshimeve të rëndësishme të vlerave, si dhe të ndonjë zhvillimi të ndodhur gjatë periudhës 6-mujore në fjalë, të cilat pasqyrohen në bilanc dhe në pasqyrën e fitimit dhe humbjeve.

Neni 7
Transaksionet kryesore me palë të lidhura

1. Në raportet e ndërmjetme të drejtimit të brendshëm, emetuesit e aksioneve duhet të publikojnë si transaksione kryesore me palë të lidhura, të paktën:

a) transaksionet me palë të lidhura, që kanë ndodhur gjatë 6 muajve të parë të vitit aktual financiar dhe që kanë ndikuar ndjeshëm në pozicionin financiar ose në performancën e shoqërisë gjatë asaj periudhe;

b) çdo ndryshim në transaksionet me palë të lidhura, të përshkruara në raportin vjetor të fundit, që mund të ketë një efekt të rëndësishëm për pozicionin financiar ose performancën e shoqërisë gjatë 6 muajve të parë të vitit aktual financiar.

2. Kur emetuesi i aksioneve nuk është i detyruar të përgatisë pasqyrat e konsoliduara, ai publikon minimalisht transaksionet me palë të lidhura sipas kërkesave të legjislacionit për kontabilitetin.

3. Autoriteti miraton rregullore për kriteret për transaksionet kryesore me palë të lidhura që i nënshtrohen detyrimit për publikim.

Neni 8
Raporti për pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore

1. Emetuesit aktivë në industritë nxjerrëse ose shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve, të përkufizuar në legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, përgatisin çdo vit një raport për pagesat e kryera ndaj institucioneve shtetërore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të përmendur në këtë nen.

2. Raporti publikohet jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i çdo viti financiar dhe duhet të jetë i disponueshëm për publikun për të paktën 10 vjet. Pagesat ndaj institucioneve shtetërore raportohen në nivel të konsoliduar.

Neni 9
Përgjegjësitë dhe detyrimet

1. Emetuesi dhe anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, sipas kompetencave të tyre përkatëse, janë përgjegjës për hartimin, saktësinë, plotësinë dhe publikimin e informacionit, në përputhje me kërkesat e neneve 4, 5, 6, 7, 8 dhe 24 të këtij ligji.

2. Dispozitat e legjislacionit në fuqi, që rregullojnë përgjegjësinë, zbatohen ndaj emetuesve dhe organeve të përmendura në këtë nen ose personave përgjegjës brenda emetuesit.

Neni 10
Përjashtime

1. Parashikimet e neneve 4 dhe 5 të këtij ligji nuk zbatohen për emetuesit, si më poshtë:

a) qeverinë e Republikës së Shqipërisë, njësitë e qeverive vendore në Republikën e Shqipërisë, një shtet anëtar i Bashkimit Evropian apo një prej autoriteteve të tij rajonale ose vendore, një organ publik ndërkombëtar, anëtar i të cilit është të paktën një shtet anëtar, Bankën Qendrore Evropiane (ECB), Fondin Evropian të Stabilitetit Financiar (EFSF), i krijuar nga marrëveshja kuadër e EFSF-së, dhe për çdo mekanizëm tjetër të krijuar me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar të Bashkimit Monetar Evropian, që ofron ndihmë të përkohshme financiare për shtetet anëtare, monedha e të cilave është euro, si dhe Bankën e Shqipërisë dhe bankat qendrore kombëtare të shteteve anëtare, pavarësisht nëse ato emetojnë aksione apo tituj të tjerë;

b) një emetues ekskluzivisht i titujve të borxhit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalente në lekë me 100 000 euro ose kur titujt

e borxhit janë të denominuar në një monedhë tjetër nga euro, vlera për njësi në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 100 000 eurove.

2. Parashikimet e nenit 5 të këtij ligji mund të mos zbatohen për institucionet e kreditit, aksionet e të cilave nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe të cilat në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur kanë emetuar vetëm tituj borxhi, me kusht që vlera nominale totale e të gjithë këtyre titujve të borxhit të mbetet nën ekuivalentin në lekë të 10 000 000 eurove dhe nuk kanë publikuar prospekt sipas kërkesave të legjislacionit që rregullon tregjet e kapitalit dhe në përputhje me të drejtën evropiane për prospektin, që publikohet kur titujt i ofrohen publikut ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.

3. Pavarësisht parashikimit të shkronjës "b", të pikës 1 të këtij neni, nenet 4 dhe 5 të këtij ligji nuk zbatohen për emetuesit e titujve të borxhit, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalenti në lekë i 50 000 eurove. Në rastin e titujve të borxhit të denominuar në një monedhë tjetër përveç euros, vlera për njësi në datën e emetimit është e barabartë me të paktën vlerën ekuivalente në lekë të 50 000 eurove, të cilat janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Bashkimin Evropian, para datës 31 dhjetor 2010, për aq kohë sa këta tituj të borxhit janë në qarkullim.

Neni 11
Mekanizmat e kontrollit të Autoritetit në lidhje me krijuesit e tregut

1. Krijuesi i tregut që kërkon të përfitojë nga përjashtimi i parashikuar në pikën 5, të nenit 12 të këtij ligji, njofton Autoritetin, në cilësinë e autoritetit përgjegjës të shtetit të origjinës së emetuesit, brenda 4 ditëve tregtimi se ai ushtron ose synon të ushtrojë veprimtari të krijimit të tregut për një emetues të caktuar.

Krijuesi i tregut e njofton Autoritetin edhe kur ai ndalon ushtrimin e veprimtarisë së krijimit të tregut për emetuesin përkatës.

2. Pa cenuar zbatimin e nenit 36 të këtij ligji, nëse Autoriteti kërkon nga krijuesi i tregut që përfiton nga përjashtimi, sipas pikës 5, të nenit 12 të këtij ligji, të identifikojë aksionet ose instrumentet e tjera financiare të mbajtura për qëllimet e veprimtarisë së krijimit të tregut, krijuesi i tregut kryen identifikimin me çdo mjet të verifikueshëm. Vetëm në rast se krijuesi i tregut nuk është në gjendje të identifikojë aksionet ose instrumentet financiare përkatëse, ai duhet t'i mbajë ato në një llogari të veçantë për qëllime të identifikimit.

3. Pa cenuar zbatimin e shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 36 të këtij ligji, kur sipas legjislacionit kombëtar kërkohet një marrëveshje për krijimin e tregut ndërmjet krijuesit të tregut dhe bursës dhe/ose emetuesit, krijuesi i tregut, me kërkesë të Autoritetit, vë në dispozicion një kopje të marrëveshjes përkatëse.

KREU III
INFORMACIONI I VAZHDUESHËM

SEKSIONI I
INFORMACION PËR PJESËMARRJET INFLUENCUESE NË KAPITAL

Neni 12
Njoftimi i blerjes ose shitjes së pjesëmarrjeve influencuese në kapital

1. Aksionari që blen ose shet aksionet e emetuesit, aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe me të cilat lidhen të drejtat e votës, njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës së emetuesit, që zotërohen nga aksionari si rezultat i blerjes ose shitjes, kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie në kufirin prej 5%, 10%, 15%, 20%, 25%, 30%, 50% dhe 75%.

Të drejtat e votës llogariten mbi bazën e të gjitha aksioneve me të cilat lidhen të drejtat e votës, edhe nëse ushtrimi i tyre është pezulluar. Ky informacion jepet edhe për të gjitha aksionet që janë në të njëjtën klasë dhe me të cilat lidhen të drejtat e votës.

2. Aksionari njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës, kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie në kufijtë e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, si rezultat i ngjarjeve që ndryshojnë përbërjen e të drejtave të votës dhe mbi bazën e informacionit të bërë publik sipas nenit 23 të këtij ligji. Në rast se emetuesi është themeluar në një shtet të tretë, njoftimi bëhet për ngjarje të barasvlershme.

3. Në Republikën e Shqipërisë, në cilësinë e shtetit të origjinës, nuk zbatohet:

a) kufiri prej 30% në rastet kur zbatohet kufiri i një të tretës;

b) kufiri prej 75 % në rastet kur zbatohet kufiri i dy të tretës.

4. Ky nen nuk gjen zbatim për aksionet e blera vetëm për qëllime të klerimit dhe shlyerjes, brenda ciklit të shkurtër të zakonshëm të shlyerjes ose për kujdestarët që mbajnë aksione në cilësinë e tyre të kujdestarit, me kusht që këta kujdestarë të mund të ushtrojnë vetëm të drejtat e votës që janë të lidhura me këto aksione, sipas udhëzimeve të dhëna me shkrim, ose me anë të mjeteve elektronike. Afati maksimal i ciklit të shkurtër të zakonshëm të shlyerjes është 3 ditë tregtimi pas transaksionit.

5. Ky nen nuk gjen zbatim për blerjen ose shitjen e pjesëmarrjeve influencuese në kapital, që arrijnë ose tejkalojnë kufirin prej 5% nga një krijues tregu që vepron në cilësinë e tij si i tillë, me kusht që:

a) të jetë i licencuar nga Autoriteti apo autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit;

b) të mos ndërhyjë as në administrimin e emetuesit në fjalë, as të ushtrojë ndikim për këtë emetues për blerjen e këtyre aksioneve ose për të mbështetur çmimin e aksioneve.

6. Ky nen nuk gjen zbatim për të drejtat e votës të mbajtura në librin e tregtimit të një institucioni krediti apo shoqërie komisionere, të përkufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe shoqërive komisionere, me kusht që:

a) të drejtat e votës të mbajtura në librin e tregtimit të mos tejkalojnë 5%;

b) të drejtat e votës të lidhura me aksionet e mbajtura në librin e tregtimit të mos ushtrohen dhe të mos përdoren për të ndërhyrë ose për të ndikuar në drejtimin ose menaxhimin e emetuesit.

Përjashtohen nga zbatimi i kësaj pike instrumentet financiare të mbajtura nga një person fizik ose juridik, i cili ekzekuton urdhra të marrë nga klientët, i përgjigjet kërkesës së një klienti për të kryer tregtim jo për llogari të vet (jo mbi bazë pronësore) ose mbulon rrezikun e pozicioneve që lindin nga këto transaksione.

7. Ky nen nuk zbatohet për të drejtat e votës, që lidhen me aksionet e blera për qëllime stabilizimi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, lidhur me përjashtimet për programet e riblerjes dhe stabilizimin e instrumenteve financiare, me kusht që të drejtat e votës, të cilat përkojnë me këto aksione, të mos ushtrohen apo përdoren për të ndërhyrë në drejtimin e emetuesit.

8. Me qëllim llogaritjen e kufirit prej 5%, të parashikuar në pikat 5 dhe 6 të këtij neni, pjesëmarrjet sipas këtij neni dhe neneve 13 dhe 20 të këtij ligji llogariten si agregate ose bashkohen dhe, në rastin e një grupi shoqërish, pjesëmarrjet grumbullohen në nivel grupi, sipas parimit të parashikuar në shkronjën “d”, të nenit 13, të këtij ligji.

Neni 13
Përvetësimi ose tjetërsimi i të drejtave të votës

Kërkesat për njoftim, të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 12 të këtij ligji, gjejnë zbatim edhe për personin fizik ose juridik në masën që ai ka të drejtë të përvetësojë, të tjetërsojë ose të ushtrojë të drejtat e votës në cilëndo nga rastet e mëposhtme ose në një kombinim të tyre:

a) të drejtat e votës që zotërohen nga një person i tretë me të cilin ky person ose subjekt ka lidhur një marrëveshje, e cila i detyron të miratojnë një politikë të përbashkët që zgjat në kohë për drejtimin e emetuesit në fjalë, me anë të ushtrimit të përbashkët të të drejtave të votimit që zotërojnë;

b) të drejtat e votës që zotërohen nga një person i tretë në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me atë person ose subjekt, që parashikon transferimin e përkohshëm për marrjen në konsideratë të të drejtave të votimit në fjalë;

c) të drejtat e votës që lidhen me aksionet, të cilat i janë dhënë këtij personi ose subjekti si kolateral, me kusht që personi ose subjekti të kontrollojë të drejtat e votimit dhe të deklarojë qëllimin që ka për ushtrimin e tyre;

ç) të drejtat e votës që lidhen me aksionet, në të cilat personi ose subjekti ka interes gjatë jetës (uzufruktin);

d) të drejtat e votës që zotërohen ose mund të ushtrohen në kuptim të shkronjave "a" deri në "ç" të këtij neni nga shoqëria që kontrollohet nga ai person apo subjekt;

dh) të drejtat e votës që lidhen me aksionet e depozituara te ky person ose subjekt, të cilat personi ose subjekti mund t'i ushtrojë sipas gjykimit të tij, në mungesë të udhëzimeve konkrete nga aksionarët;

e) të drejtat e votës që zotërohen nga një person i tretë, në emrin e vet ose për llogari të këtij personi ose subjekti;

ë) të drejtat e votës që personi ose subjekti mund t'i ushtrojë si përfaqësues (*proxy*), kur mund t'i ushtrojë ato sipas diskrecionit të vet, në mungesë të udhëzimeve specifike nga aksionarët.

Neni 14

Përjashtime për qëllime të politikës monetare

1. Shkronja "c" e nenit 13 të këtij ligji nuk zbatohet për aksionet e dhëna ose të marra nga anëtarët e sistemit evropian të bankave qendrore (në vijim ESCB) gjatë kryerjes së funksioneve të tyre si autoritete monetare, duke përfshirë aksionet e dhëna ose të marra nga anëtarët e ESCB-së, në formën e një garancie, riblerjeje apo një marrëveshjeje të ngjashme për sigurimin e likuiditetit për qëllime të politikës monetare ose brenda një sistemi pagesash.

2. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet për transaksionet e mësipërme që zgjasin për një periudhë të shkurtër, me kusht që të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione të mos ushtrohen.

Neni 15

Procedurat e njoftimit dhe publikimit të informacionit për pjesëmarrjet influencuese në kapital

1. Njoftimi i parashikuar në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji përfshin të dhënat e mëposhtme:

a) gjendjen në lidhje me të drejtat e votës;

b) zinxhirin e sipërmarrjeve të kontrolluara përmes të cilave zotërohen efektivisht të drejtat e votës, kur ka;

c) datën kur është arritur ose është tejkaluar kufiri;

ç) identitetin e aksionarit, edhe nëse aksionari nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e votës sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji, si dhe identitetin e personit fizik ose juridik që ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e votës për llogari të këtij aksionari.

2. Emetuesi njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 4 ditë tregtimi pas datës në të cilën aksionari ose personi fizik apo juridik, i parashikuar në nenin 13 të këtij ligji:

a) merr dijeni për blerjen ose shitjen apo për mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votës ose për të cilat duhej të kishte marrë dijeni, duke pasur parasysh rrethanat, pavarësisht datës në të cilën hyn në fuqi blerja, shitja ose mundësia e ushtrimit të të drejtave të votës; ose

b) merr njoftim për ngjarjen e parashikuar në pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji.

3. Një sipërmarrje përjashtohet nga kryerja e njoftimit të kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse njoftimi bëhet nga shoqëria e saj mëmë ose kur vetë shoqëria mëmë është shoqëri e kontrolluar nga shoqëria mëmë e saj.

4. Për qëllim të neneve 12 dhe 13 të këtij ligji, shoqëria mëmë e një shoqërie administruese nuk kërkohet të bashkojë zotërimet e saj me zotërimet që administron shoqëria administruese, sipas kërkesave të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, me kusht që kjo e fundit të ushtrojë të drejtat e saj të votës në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë.

Nenet 12 dhe 13 të këtij ligji zbatohen në rastet kur shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë ka investuar në zotërime të administruara nga kjo shoqëri administruese dhe kur kjo e fundit nuk ka diskrecion për të ushtruar të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione dhe mund t'i ushtrojë këto të drejta vetëm sipas udhëzimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë.

5. Shoqëria mëmë e një shoqërie komisionere, e licencuar sipas ligjit për tregjet e kapitalit, nuk kërkohet, për qëllim të përcaktimeve në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, të bashkojë zotërimet e saj me aksionet që kjo shoqëri komisionere administron për llogari të klientëve, në kuptim të ligjit për tregjet e kapitalit, me kusht që:

a) shoqëria komisionere të jetë e licencuar për administrimin e portofolit individual, sipas kërkesave të ligjit për tregjet e kapitalit;

b) të mund të ushtrojë vetëm të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione, sipas udhëzimeve të dhëna me shkrim apo në mënyrë elektronike, ose të garantojë që shërbimet e administrimit të portofolit individual të ofrohen në mënyrë të pavarur nga çdo shërbim tjetër, në kushte të barasvlershme me ato të parashikuara në legjislacionin për sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, duke caktuar mekanizmat e duhur;

c) shoqëria komisionere ushtron të drejtat e saj të votës në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë.

Nenet 12 dhe 13 të këtij ligji zbatohen në rastet kur shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë ka investuar në aksione të administruara nga kjo shoqëri komisionere dhe kjo e fundit nuk ka diskrecion për të ushtruar të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione dhe mund t'i ushtrojë këto të drejta vetëm sipas udhëzimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga shoqëria mëmë ose nga një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë.

6. Pas marrjes së njoftimit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, por jo më vonë se 3 ditë tregtimi, emetuesi bën publik të gjithë informacionin që përmban njoftimi.

7. Emetuesi përjashtohet nga parashikimi i pikës 6 të këtij neni nëse informacioni i përfshirë në njoftim publikohet nga Autoriteti menjëherë pas marrjes së tij dhe në çdo rast jo më vonë se tri ditë tregtimi nga data e marrjes së njoftimit, sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji.

Neni 16

Aksionarët dhe personat fizikë ose juridikë që detyrohen të njoftojnë për pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital

1. Për qëllim të pikës 2 të nenit 15 të këtij ligji, detyrimi për njoftim për pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital, që lind në rast se përqindja e të drejtave të votës të mbajtura nga secila palë, arrin, tejkalon ose bie nën pragun e zbatueshëm pas transaksioneve të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji është një detyrim individual, që i takon secilit aksionar ose secilit person fizik ose juridik, siç përmendet në nenin 13 të këtij ligji ose të dyjave në rast se përqindja e të drejtave të votës të mbajtura nga secila palë arrin, tejkalon ose bie nën pragun e zbatueshëm. Në rrethanat e përmendura në shkronjën "a", të nenit 13 të këtij ligji detyrimi për njoftim do të jetë një detyrim kolektiv i ndarë midis të gjitha palëve në marrëveshje.

2. Në rrethanat e parashikuara në shkronjën "ë", të nenit 13 të këtij ligji, nëse një aksionar jep prokurën për përfaqësimin në një mbledhje aksionarësh, njoftimi bëhet në momentin e dhënies së prokurës, me kusht që në njoftim të sqarohet se cila do të jetë situata që do të rezultojë në aspektin e të drejtave të votës, kur mbajtësi i prokurës ushtron të drejtat e votës, sipas gjykimit të tij.

3. Nëse në kushtet e përmendura në shkronjën "ë" të nenit 13 të këtij ligji mbajtësi i prokurës merr një ose disa prokura për një mbledhje aksionarësh, njoftimi mund të bëhet me anë të një njoftimi të vetëm në momentin e marrjes së prokurave, me kusht që në njoftim të sqarohet se cila do të jetë situata

që do të rezultojë në aspektin e të drejtave të votës kur mbajtësi i prokurës nuk mund të ushtrojë më të drejtat e votës, sipas gjykimit të tij.

4. Kur detyrimi për të bërë një njoftim i takon më shumë se një personi fizik ose juridik, njoftimi mund të bëhet me anë të një njoftimi të vetëm të përbashkët. Megjithatë, përdorimi i një njoftimi të vetëm të përbashkët nuk mund të konsiderohet si lirim nga përgjegjësia i ndonjërit prej personave fizikë ose juridikë të përfshirë në lidhje me njoftimin.

Neni 17

Rrethanat në të cilat personi njoftues duhet të kishte marrë dijeni për blerjen ose shitjen ose për mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votës

Për qëllim të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 15 të këtij ligji, aksionari ose personi fizik apo juridik, i parashikuar në nenin 13 të këtij ligji, konsiderohet se ka marrë dijeni për blerjen, shitjen ose mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votës jo më vonë se dy ditë tregtimi pas kryerjes së transaksionit.

Neni 18

Kushtet e pavarësisë që duhet të përmbushen nga shoqëria administruese dhe shoqëria komisionere, të përfshira në administrimin e portofolit individual

1. Për qëllimet e përjashtimit nga bashkimi i zotërimeve, të parashikuara në nënparagrafët e parë të pikave 4 dhe 5 të nenit 15 të këtij ligji, shoqëria mëmë e një shoqërie administruese ose e një shoqërie komisionere duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) të mos ndërhyjë drejtpërdrejt ose të tërthorazi duke dhënë udhëzime ose në ndonjë mënyrë tjetër në ushtrimin e të drejtave të votës, të mbajtura nga ajo shoqëri administruese ose nga shoqërie komisionere;

b) shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të jetë e lirë të ushtrojë në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë të drejtat e votës të lidhura me asetet që ajo administron.

2. Shoqëria mëmë, që synon të përfitojë nga përjashtimi, njofton pa vonesë Autoritetin, në cilësinë e autoriteti kompetent të shtetit anëtar të origjinës së emetuesve, të drejtat e votës së të cilëve janë të lidhura me zotërimet e administruara nga shoqëritë administruese ose nga shoqëritë komisionere si më poshtë:

a) një listë të emrave të atyre shoqërive administruese ose shoqërive komisionere, duke treguar autoritetet kompetente që i mbikëqyrin ato, ose që asnjë autoritet kompetent nuk i mbikëqyr ato, por pa iu referuar emetuesve përkatës;

b) një deklaratë që në rastin e secilës shoqëri administruese ose shoqëri komisionere shoqëria mëmë përmbush kushtet e përcaktuara në pikën të këtij neni.

Shoqëria mëmë duhet ta përditësojë listën e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni në mënyrë të vazhdueshme.

3. Kur shoqëria mëmë synon të përfitojë nga përjashtimi vetëm në lidhje me instrumentet financiare të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, ajo duhet t'i njoftojë Autoritetit, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës së emetuesit, vetëm listën e përmendur në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni.

4. Pa cenuar zbatimin e nenit 36 të këtij ligji, një shoqëri mëmë e një shoqërie administruese ose e një shoqërie komisionere duhet të jetë në gjendje t'i tregojë autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së emetuesit, me kërkesë të tij, se:

a) të drejtat e votës së shoqërisë mëmë, të shoqërisë administruese ose shoqërisë komisionere ushtrohen në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë;

b) personat që vendosin se si do të ushtrohen të drejtat e votës veprojnë në mënyrë të pavarur;

c) nëse shoqëria mëmë është klient i shoqërisë së saj të administrimit ose shoqërisë komisionere apo zotëron pjesëmarrje në aktivet e administruara nga shoqëria administruese ose nga shoqëria komisionere, ekziston një mandat i qartë me shkrim për një marrëdhënie të pavarur "*armslength*" me

klientin me kushte të barabarta ndërmjet shoqërisë mëmë dhe shoqërisë administruese ose shoqërisë komisionere.

Kërkesa në shkronjën "a" të kësaj pike nënkupton, si minimum, që shoqëria mëmë dhe shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të hartojnë politika dhe procedura me shkrim, në mënyrë të arsyeshme për të parandaluar shpërndarjen e informacionit ndërmjet shoqërisë mëmë dhe shoqërisë administruese ose shoqërisë komisionere në lidhje me ushtrimin e të drejtave të votës.

5. Për qëllimet e shkronjës "a", të pikës 1 të këtij neni, "udhëzim i drejtpërdrejtë" është çdo udhëzim i dhënë nga shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë, që specifikon se si do të ushtrohen të drejtat e votës nga shoqëria administruese ose nga shoqëria komisionere në raste të veçanta. "Udhëzim i tërthortë" është çdo udhëzim i përgjithshëm ose i veçantë, pavarësisht nga forma, i dhënë nga shoqëria mëmë ose nga një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë, që kufizon diskrecionin e shoqërisë administruese ose të shoqërisë komisionere në lidhje me ushtrimin e të drejtave të votës, në funksion të interesave specifike të biznesit të shoqërisë mëmë ose një shoqërie tjetër të kontrolluar të shoqërisë mëmë.

Neni 19

Instrumentet financiare që i japin mbajtësit të drejtën për të përfituar, vetëm me iniciativën e tij, aksione të lidhura me të drejta vote

1. Njoftimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 20 të këtij ligji duhet të përfshijë informacionin si më poshtë:

a) situatën përfundimtare në lidhje me të drejtat e votës;

b) nëse është e zbatueshme, zinxhirin e ndërmarrjeve të kontrolluara përmes të cilave instrumentet financiare mbahen në mënyrë efektive;

c) datën në të cilën pragu përkatës është arritur ose është kaluar;

ç) për instrumentet që kanë një periudhë ushtrimi, tregimin e datës ose periudhës kohore kur aksionet do të mund të fitohen ose të ushtrohen, nëse është e aplikueshme;

d) datën e maturimit ose të skadimit të instrumentit;

dh) identitetin e mbajtësit;

e) emrin e emetuesit bazë.

Në kuptim të përcaktimeve të shkronjës "a" të kësaj pike, përqindja e të drejtave të votës duhet të llogaritet në raport me numrin total të të drejtave të votës dhe kapitalit, siç është publikuar së fundi nga emetuesi, në përputhje me nenin 23 të këtij ligji.

2. Njoftimi do të kryhet sipas afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 15 të këtij ligji.

3. Njoftimi do t'i dërgohet emetuesit të aksioneve bazë dhe autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së atij emetuesi.

Në rastet kur një instrument financiar lidhet me më shumë se një aksion bazë, atëherë do të bëhet një njoftim i veçantë për secilin emetues të aksioneve bazë.

Neni 20

Detyrimi për njoftim

1. Kërkesat për njoftim, të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, zbatohen edhe për personat fizikë ose juridikë që zotërojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi:

a) instrumente financiare që pas maturimit i japin zotëruesit të tyre mbi bazën e një marrëveshjeje formale të drejtën e pakushtëzuar për të përfituar ose diskrecionin lidhur me të drejtën e tij për të përfituar aksione të shoqëruara me të drejta vote, të cilat janë emetuar nga një emetues, aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

b) instrumente financiare, të cilat nuk përfshihen në shkronjën "a" të kësaj pike, por u referohen aksioneve dhe kanë efekt ekonomik të ngjashëm me instrumentet financiare të parashikuara në atë shkronjë, pavarësisht nëse japin ose jo të drejtën e shlyerjes fizike.

Njoftimi i kërkuar përfshin ndarjen sipas llojit të instrumenteve financiare të zotëruara, në përputhje me shkronjën "a" të kësaj pike dhe sipas llojit të instrumenteve financiare të zotëruara, në përputhje me shkronjën "b" të kësaj pike, që bën dallimin ndërmjet instrumenteve financiare, të cilat japin të drejtën e shlyerjes fizike dhe instrumenteve financiare, që japin të drejtën e shlyerjes me mjete monetare (*cash*).

2. Numri i të drejtave të votës përllogaritet duke iu referuar shumës së plotë nominale të aksioneve, që janë në bazë të instrumentit financiar, përveçse kur instrumenti financiar parashikon vetëm shlyerjen me mjete monetare (*cash*), rast në të cilin numri i drejtave të votës përllogaritet mbi bazën e një "koeficienti delta të korrigjuar", duke shumëzuar shumën nominale të aksioneve bazë me koeficientin delta të instrumentit. Për këtë qëllim zotëruesi bashkon dhe njofton të gjitha instrumentet financiare që lidhen me të njëjtin emetues bazë. Për përllogaritjen e të drejtave të votës merren në konsideratë vetëm pozicionet afatgjata. Pozicionet afatgjata nuk kompensohen me pozicionet afatshkurtra të të njëjtit emetues bazë.

Të drejtat e votës, të përmendura në këtë pikë, në rastin e një instrumenti financiar, të referuar ndaj një shporte aksionesh ose një indeksi, llogariten mbi bazën e peshës së aksionit në shportën e aksioneve ose në indeks kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) të drejtat e votës në një emetues të caktuar, të mbajtura nëpërmjet instrumenteve financiare, të referuara ndaj shportës ose indeksit, përfaqësojnë 1% ose më shumë të të drejtave të votës që u bashkëlidhen aksioneve të atij emetuesi;

b) aksionet në shportë ose në indeks përfaqësojnë 20% ose më shumë të vlerës së titujve në shportë ose në indeks.

Kur një instrument financiar i referohet një serie shportash aksionesh ose indeksesh, të drejtat e votës, të mbajtura përmes shportave ose indekseve individuale, nuk grumbullohen për qëllimet e pragjeve të përcaktuara në këtë pikë.

3. Numri i të drejtave të votës që lidhen me instrumente financiare, të cilat parashikojnë ekskluzivisht shlyerje në para dhe kanë një profil linear e simetrik kthimi në raport me aksionin bazë, llogaritet mbi bazë të rregulluar, sipas deltës, ku pozicioni në para konsiderohet i barabartë me 1.

Numri i të drejtave të votës që lidhen me një instrument financiar të shlyer ekskluzivisht në para, i cili nuk ka një profil linear e simetrik kthimi në raport me aksionin bazë, llogaritet mbi bazë të rregulluar sipas deltës, duke përdorur një model standard çmimi të pranuar gjerësisht.

Një model standard çmimi i pranuar gjerësisht është një model që përdoret zakonisht në industrinë financiare për atë instrument financiar dhe që është mjaftueshëm i qëndrueshëm për të marrë parasysh elementet që janë të rëndësishme për vlerësimin e instrumentit. Elementet që janë të rëndësishme për vlerësimin përfshijnë të paktën:

a) normën e interesit;

b) pagesat e dividendëve;

c) kohën deri në maturim;

ç) paqëndrueshmërinë (*volatilitetin*);

d) çmimin e aksionit bazë.

Gjatë përcaktimit të deltës, mbajtësi i instrumentit financiar duhet të sigurojë që:

i. modeli i përdorur të mbulojë kompleksitetin dhe rrezikun e çdo instrumenti financiar;

ii. i njëjti model të përdoret në mënyrë të qëndrueshme për llogaritjen e numrit të të drejtave të votës për një instrument financiar të caktuar.

Sistemet e teknologjisë së informacionit të përdorura për kryerjen e llogaritjes së deltës duhet të sigurojnë raportim të qëndrueshëm, të saktë dhe në kohë të të drejtave të votës.

Numri i të drejtave të votës llogaritet çdo ditë duke marrë parasysh çmimin e fundit të mbylljes së aksionit bazë. Mbajtësi i instrumentit financiar njofton emetuesin kur arrin, tejkalon ose bie nën pragjet e parashikuara në pikën 1, të nenit 12 të këtij ligji.

4. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, nëse plotësohet një prej kushteve të përcaktuara në shkronjat "a" ose "b" të kësaj pike, konsiderohen si instrumente financiare:

a) titujt e transferueshëm;

b) kontratat e opsioneve (*option*);

c) kontratat e së ardhmes (*future*);

ç) kontratat e shkëmbimit (*swap*);

d) marrëveshjet për normat e ardhshme të këmbimit (*forward rate*);

dh) kontratat për diferencë;

e) çdo kontratë ose marrëveshje tjetër me efekte ekonomike të ngjashme, e cila mund të shlyhet fizikisht apo me mjete monetare.

Autoriteti publikon një listë treguese të instrumenteve financiare, që u nënshtrohen kërkesave për njoftim, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë zhvillimet teknike në tregjet financiare, hartuar dhe përditësuar periodikisht nga Autoriteti Evropian i Tregjeve të Titujve (në vijim ESMA).

5. Për të siguruar kushte të njëtrajtshme të zbatimit të pikës 1 të këtij neni dhe për të marrë parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare, Autoriteti harton rregulla, në përputhje me standarde teknike zbatuese të hartuara nga ESMA, me qëllim përcaktimin e formateve standarde, modeleve dhe procedurave standarde, që përdoren kur njoftohet informacioni i kërkuar tek emetuesi, sipas pikës 1 të këtij neni, ose kur depozitohet informacioni në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenin 27 të këtij ligji.

6. Përjashtimet e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 12 dhe në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 15 zbatohen rast pas rasti për kërkesat për njoftim sipas këtij neni.

Neni 21

Bashkimi i të drejtave të votës/agregimi

1. Kërkesat për njoftim, të përcaktuara në nenet 12, 13 dhe 20 të këtij ligji, zbatohen edhe për personat fizikë ose juridikë, kur numri i të drejtave të votës, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ky person apo subjekt, sipas neneve 12 dhe 13 të këtij ligji, së bashku me numrin e të drejtave të votës, që lidhen me instrumentet financiare, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sipas nenit 20 të këtij ligji, arrin, tejkalon apo bie nën kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji.

Njoftimi i kërkuar në këtë pikë duhet të përfshijë ndarjen e numrit të të drejtave të votës, që përkojnë me aksionet e zotëruara, në përputhje me parashikimet e neneve 12 dhe 13 të këtij ligji, dhe të drejtat e votës që lidhen me instrumentet financiare, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji.

2. Të drejtat e votës që lidhen me instrumentet financiare të njoftuara, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, i nënshtrohen një njoftimi të ri kur personi fizik ose juridik ka përfituar aksionet bazë dhe si rezultat i këtij përfitimi numri total i të drejtave të votës, të lidhura me aksionet e emetuara nga i njëjti emetues, arrin ose tejkalon kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 22

Detyrimi për publikim i emetuesit

1. Nëse një emetues i aksioneve të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar dhe për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës, blen ose shet aksionet e veta, vetë ose nëpërmjet një personi, që vepron në emër të tij, por për llogari të emetuesit, emetuesi bën publik përqindjen e aksioneve të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 4 ditë tregtimi pas blerjes ose shitjes, kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie nën kufirin prej 5% ose 10% të të drejtave të votës. Përqindja llogaritet në bazë të numrit total të aksioneve me të cilat lidhen të drejtat e votës.

2. Autoriteti miraton rregullore për përcaktimin e rregullave të detajuara në zbatim të përcaktimeve në këtë nen, duke marrë në konsideratë aktet e deleguara të Komisionit Evropian në fushën përkatëse, si dhe duke pasur parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare.

Neni 23

Publikimi i të drejtave të votës

Për qëllim të llogaritjes së kufijve të parashikuar në nenin 12 të këtij ligji, emetuesi për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës publikon numrin total të të drejtave të votës dhe të kapitalit në fund të çdo muaji kalendarik gjatë të cilit ka pasur një rritje ose ulje të numrit total.

Neni 24
Informacione shtesë

1. Emetuesi i aksioneve të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar publikon pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat që lidhen me klasa të ndryshme të aksioneve, duke përfshirë ndryshimet në të drejtat që lidhen me titujt derivativë, të emetuar nga vetë emetuesi, që japin akses në aksionet e tij.

2. Emetuesi i titujve të tjerë, përveç aksioneve, të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar, bën publike pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat e mbajtësit të titujve të tjerë përveç aksioneve, duke përfshirë ndryshimet në kushtet dhe termat e këtyre titujve, që mund të ndikojnë në mënyrë indirekte te këto të drejta, që lindin veçanërisht nga ndryshimi i termave të huas ose i normave të interesit.

Seksioni II
Informacioni për mbajtësit e titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

Neni 25
Kërkesat për informacion nga emetuesit, aksionet e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

1. Emetuesi i aksioneve të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar siguron trajtim të barabartë për të gjithë mbajtësit e aksioneve që kanë të njëjtin pozicion.

2. Emetuesi siguron vënien në dispozicion të të gjitha mjeteve dhe informacioneve të nevojshme për ushtrimin e të drejtave të mbajtësve të aksioneve në Republikën e Shqipërisë, në cilësinë e saj si shtet i origjinës, si dhe garanton ruajtjen e integritetit të të dhënave. Aksionarët nuk ndalohen të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është themeluar emetuesi. Veçanërisht emetuesi duhet:

a) të informojë për vendin, orën dhe agjendën e mbledhjeve, numrin e përgjithshëm të aksioneve dhe të drejtave të votimit, si dhe të drejtat e mbajtësve për të marrë pjesë në mbledhje;

b) të vërë në dispozicion një formular përfaqësimi, në formë fizike ose, kur është rasti, përmes mjeteve elektronike për çdo person me të drejtë vote në asamblenë e aksionarëve së bashku me njoftimin për mbledhjen ose, kur kërkohet, pas shpalljes së mbledhjes;

c) të caktojë si agjent një institucion financiar, përmes të cilit aksionarët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre financiare;

ç) të publikojë njoftime ose të shpërndajë informacion lidhur me shpërndarjen dhe pagesën e dividendëve dhe emetimin e aksioneve të reja, përfshirë informacion për rregullat e caktimit të pjesës, nënshkrimin, anulimin ose konvertimin.

3. Për qëllim të përcjelljes së informacionit te aksionarët, emetuesi mund të përdorë mjete elektronike me kusht që vendimi të merret në asamblenë e përgjithshme dhe të përmbushë të paktën kriteret si më poshtë:

a) përdorimi i mjeteve elektronike nuk varet në asnjë mënyrë nga vendndodhja e selisë ose vendqëndrimit të aksionarit ose, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “ë”, të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji, të personave fizikë ose juridikë;

b) miratohen rregulla identifikimi në mënyrë që aksionarët ose personat fizikë apo juridikë, me të drejtë ushtrimi apo drejtimi të ushtrimit të të drejtave të votës, të informohen në mënyrë efektive;

c) aksionarët ose, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “e”, të pikës 1, të nenit 13 të këtij ligji, personat fizikë apo juridikë që kanë të drejtën e blerjes, shitjes apo ushtrimit të të drejtave të votës, kontaktohen me shkrim për t’iu kërkuar miratimin për përdorimin e mjeteve elektronike për përcjelljen e informacionit dhe, në rast se ata nuk kundërshtojnë brenda një afati të arsyeshëm, por

jo më të gjatë se 2 javë, miratimi i tyre konsiderohet i dhënë. Ata mund të kërkojnë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni t'u përcillet me shkrim;

ç) çdo shpërndarje e kostos që përfshin përcjellja e këtij informacioni me anë të mjeteve elektronike përcaktohet nga emetuesi në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Autoriteti miraton me rregullore rregulla të detajuara për zbatimin e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, në përputhje me aktet e miratuara nga Komisioni Evropian në këtë fushë e duke marrë në konsideratë zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Në veçanti, Autoriteti përcakton llojet e institucioneve financiare nëpërmjet të cilave aksionarët mund të ushtrojnë të drejtat financiare, të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 2 të këtij neni.

Neni 26

Kërkesat për informacion për emetuesit, titujt e borxhit të të cilëve pranohen për tregtim në një treg të rregulluar

1. Emetuesi i titujve të borxhit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar sigurohet që të gjithë mbajtësit e titujve të borxhit, me renditje "*pari passu*" marrin trajtim të barabartë sa u takon të drejtave që lidhen me këta tituj borxhi.

2. Emetuesi sigurohet që të gjitha mjetet dhe informacioni i nevojshëm, që u mundësohet mbajtësve të titujve të borxhit të ushtrojnë të drejtat e tyre në Republikën e Shqipërisë, në cilësinë e vendit të origjinës, janë të vlefshme publikisht dhe se do të ruhet integriteti i të dhënave. Mbajtësit e titujve të borxhit nuk ndalohen të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është themeluar emetuesi. Veçanërisht emetuesi duhet:

a) të publikojë njoftimet ose të shpërndajë informacion lidhur me vendin, orën dhe agjendën e mbledhjeve të mbajtësve të titujve të borxhit, pagesën e interesit, ushtrimin e të drejtave të konvertimit, këmbimit, nënshkrimit ose anulimit e shlyerjen, si dhe të drejtën e këtyre mbajtësve për të marrë pjesë në to;

b) të vërë në dispozicion formularin e përfaqësimit në formë shkresore ose, kur është e mundur, me anë të mjeteve elektronike për çdo person me të drejtë vote në mbledhjen e mbajtësve të titujve të borxhit, së bashku me njoftimin për mbledhjen ose, me kërkesë, pas njoftimit të mbledhjes;

c) të caktojë si agjent një institucion financiar përmes të cilit mbajtësit e titujve të borxhit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre financiare.

3. Nëse në mbledhje ftohen vetëm mbajtësit e titujve të borxhit, vlera për njësi e të cilëve arrin të paktën ekuivalentin në lekë të 100 000 eurove, në rastin e titujve të borxhit, në monedhë të ndryshme nga euro, vlera për njësi e të cilëve në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 100 000 eurove, emetuesi mund të zgjedhë si vendndodhje cilindo shtet anëtar, me kusht që në atë shtet anëtar të vihen në dispozicion të gjitha mjetet dhe informacionet e nevojshme për t'u mundësuar këtyre mbajtësve ushtrimin e të drejtave të tyre.

Zgjedhja e emetuesit, e parashikuar në këtë pikë, zbatohet gjithashtu për titujt e borxhit, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalenti në lekë i 50 000 eurove, ose, në rastin e titujve të borxhit të denominuar në një valutë tjetër të ndryshme, ku vlera e kësaj njësie në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 50 000 eurove, të cilët janë pranuar tashmë për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare, përpara datës 31 dhjetor 2010, për aq kohë sa këta tituj borxhi janë në qarkullim, me kusht që të gjithë mekanizmat dhe informacionet e nevojshme për t'u mundësuar mbajtësve të tyre ushtrimin e të drejtave të tyre të vihen në dispozicion në shtetin anëtar të zgjedhur nga emetuesi.

4. Për qëllime të përcjelljes së informacionit te mbajtësit e titujve të borxhit, emetuesit mund të përdorin mjete elektronike me kusht që vendimi për këtë të merret nga asambleja e përgjithshme dhe të përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) përdorimi i mjeteve elektronike nuk varet në asnjë mënyrë nga vendndodhja e selisë ose vendqëndrimi i mbajtësit të titujve të borxhit apo të ndërmjetësit që përfaqëson këtë mbajtës;

b) miratimi i rregullave të identifikimit, në mënyrë që mbajtësit e titujve të borxhit të informohen në mënyrë efektive;

c) mbajtësit e titujve të borxhit kontaktohen me shkrim për të kërkuar miratimin e tyre për përdorimin e mjeteve elektronike të përcjelljes së informacionit dhe, në rast se nuk paraqesin kundërshtim brenda një afati të arsyeshëm, miratimi i tyre do të konsiderohet i dhënë. Ata kanë mundësi të kërkojnë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni të përcillet me shkrim;

ç) ndarjet e kostove, që përfshin përcjellja e informacionit përmes mjeteve elektronike, do të përcaktohen nga emetuesi në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Autoriteti miraton rregulla në përputhje me aktet e deleguara të Komisionit Evropian, që marrin në konsideratë zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe zhvillimet në teknologjinë e informacionit e të komunikimit për të garantuar zbatimin e pikave 1 deri në 4 të këtij neni. Në veçanti, ai specifikon llojet e institucioneve financiare nëpërmjet të cilave mbajtësit e titujve të borxhit mund të ushtrojnë të drejtat financiare të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 2 të këtij neni.

Seksioni III
Detyrime të përgjithshme

Neni 27
Kontrolli nga Autoriteti

1. Kur emetuesi ose çdo person që ka kërkuar pranimin e titujve të tij për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, dhe për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës, publikon informacion të rregulluar, ai e depoziton njëkohësisht këtë informacion pranë Autoritetit.

2. Autoriteti mund të publikojë në faqen zyrtare të internetit informacionin e depozituar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni që do t'i përcillet emetuesit, në përputhje me nenet 12, 13, 15 dhe 20, të këtij ligji, duhet të depozitohet njëkohësisht në Autoritet.

Neni 28
Gjuhët për publikimin dhe komunikimin e informacionit të rregulluar

1. Kur titujt janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar vetëm në Republikën e Shqipërisë, si shtet i origjinës së emetuesit, çdo informacion i rregulluar, mbështetur në këtë ligj, publikohet në gjuhën shqipe.

2. Kur titujt janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar edhe në Republikën e Shqipërisë, si shteti i origjinës, edhe në një ose më shumë shtete anëtare, si shtete pritëse, çdo informacion i rregulluar, në mbështetje të këtij ligji, do të publikohet:

a) në gjuhën shqipe;

b) në varësi të zgjedhjes së emetuesit, në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të atyre shteteve anëtare pritëse ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

3. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare, por jo në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, informacioni i rregulluar, në varësi të zgjedhjes së tregut nga emetuesit, publikohet në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

Gjithashtu, informacioni i rregulluar, sipas parashikimeve të kësaj pike, në varësi të zgjedhjes së emetuesit, publikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë në një gjuhë të pranuar nga Autoriteti, në këtë rast në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze, si gjuhë e zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

4. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, pa miratimin e emetuesit, detyrimi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk i takon emetuesit, por personit që ka kërkuar pranimin pa miratimin e emetuesit.

5. Aksionarët dhe personat fizikë ose juridikë të përmendur në nenet 12, 13 dhe 20 të këtij ligji lejohet t'ua përcjellin emetuesve informacionet, sipas këtij ligji, në gjuhën shqipe ose vetëm në një gjuhë të përhapur në fushën e financave ndërkombëtare. Nëse emetuesi e merr këtë njoftim, ai nuk është i detyruar të sigurojë një përkthim në gjuhën shqipe.

6. Si përjashtim nga pikat 1 deri 4 të këtij neni, kur titujt që kanë vlerë për njësi, të paktën vlerën ekuivalente në lekë të 100 000 eurove, ose në rastin e titujve të borxhit të shprehur në monedhë të ndryshme nga euro kanë vlerë për njësi ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 100 000 eurove në datën e emetimit dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare, informacioni i rregulluar i jepet publikut në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse dhe nga Autoriteti, ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare, të zgjedhur nga emetuesi ose personi i cili ka kërkuar pranimin për tregtim pa miratimin e emetuesit.

7. Përjashtimi i përmendur në pikën 6 të këtij neni zbatohet edhe për titujt e borxhit, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalenti në lekë i 50 000 eurove, ose në rastin e titujve të borxhit të denominuar në një valutë tjetër nga euroja, vlera e kësaj njësie në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën ekuivalente në lekë të 50 000 eurove, të cilët janë pranuar tashmë për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare përpara datës 31 dhjetor 2010, për aq kohë sa këta tituj borxhi janë në qarkullim.

8. Nëse pranë një gjykate të Republikës së Shqipërisë apo një shteti anëtar paraqitet një vepër në lidhje me përmbajtjen e informacionit të rregulluar, përgjegjësia për pagesën e kostove të përkthimit të këtij informacioni për qëllimet e procedimeve vendoset në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë apo shtetit anëtar.

Neni 29

Aksesi në informacionin e rregulluar

1. Emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, publikon informacionin e rregulluar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses të shpejtë dhe mbi baza jodiskriminuese të këtij informacioni dhe e vendos atë në dispozicion të mekanizmit të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni.

Emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, pa miratimin e emetuesit, nuk mund t'u vendosë asnjë kosto të posaçme investitorëve për ofrimin e këtij informacioni. Emetuesi përdor mjete komunikimi, që mbi baza të arsyeshme konsiderohen të besueshme për shpërndarjen efektive të informacionit te publiku në Republikën e Shqipërisë dhe në të gjitha shtetet anëtare. Sidoqoftë, nuk është detyrim përdorimi vetëm i atyre mjeteve të komunikimit (medieve), operatorët e të cilëve janë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti cakton një apo më shumë mekanizma zyrtarë për ruajtjen qendrore të informacionit, të rregulluar në formën e një regjistri. Ky mekanizëm duhet të jetë në përputhje me standardet minimale të cilësisë për sa i përket mbrojtjes, sigurisë së burimit të informacionit, regjistrimit të kohës dhe lehtësisë së aksesit nga përdoruesit fundorë dhe në harmoni me procedurën e depozitimit sipas pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji.

3. Emetuesi paraqet informacionin e plotë të rregulluar njëkohësisht me publikimin pranë Autoritetit dhe mekanizmit zyrtar qendror të caktuar prej Autoritetit.

4. Mekanizmi zyrtar i informacionit të rregulluar në Republikën e Shqipërisë mbahet nga Autoriteti, i cili e publikon informacionin e rregulluar në faqen zyrtare të tij.

5. Pavarësisht parashikimit të pikës 1 të këtij neni, mekanizmi zyrtar i informacionit të rregulluar mund të mbahet edhe nga një person juridik tjetër, i cili është miratuar nga Autoriteti, me kusht që të plotësojë kërkesat teknike, të sigurisë, organizative dhe kushte të tjera për mbajtjen e mekanizmit zyrtar të informacionit të rregulluar, si dhe të sigurojë që aksesimi i informacionit të rregulluar në nivelin e Bashkimit Evropian të mos cenohet.

6. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar me vendndodhje dhe që operon vetëm në Republikën e Shqipërisë si shtet pritës dhe jo si shtet i origjinës, emetuesi ose personi që ka

paraqitur kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, e publikon informacionin e rregulluar në përputhje me kërkesat e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

7. Autoriteti miraton rregullore duke marrë në konsideratë aktet e deleguara të Komisionit Evropian për specifikimin e:

a) standardeve minimale të shpërndarjes së informacionit të rregulluar, siç përmendet në pikën 1 të këtij neni;

b) standardeve minimale për mekanizmin qendror të ruajtjes, siç përmendet në pikën 2 të këtij neni;

c) rregullave që garantojnë ndërveprimin e informacionit dhe teknologjive të komunikimit të përdorura nga mekanizmat e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, si dhe aksesin në informacionin e rregulluar në nivelin e Bashkimit Evropian të përmendur në të.

Neni 30

Standardet minimale

1. Për qëllime të parashikimeve të pikës 1, të nenit 29 të këtij ligji, shpërndarja e informacionit të rregulluar kryhet në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në pikat 2 deri në 5 të këtij neni.

2. Informacioni i rregulluar duhet të shpërndahet në mënyrë të tillë që të sigurojë akses te një publik sa më i gjerë dhe në të njëjtën kohë sa më afër të jetë e mundur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e shtetit të origjinës, ose në shtetin anëtar të parashikuar në pikën 6, të nenit 29 të këtij ligji, si dhe në shtetet e tjera anëtare.

3. Informacioni i rregulluar duhet t'u komunikohet medieve në tekst të plotë të pa edituar. Në rastin e raporteve dhe deklaratave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse njoftimi për informacionin e rregulluar i komunikohet medies dhe tregon se në cilën faqe interneti, përveç mekanizmit të caktuar zyrtarisht për ruajtjen qendrore të informacionit, të rregulluar në nenin 29 të këtij ligji, janë të disponueshme dokumentet përkatëse.

4. Informacioni i rregulluar duhet t'i komunikohet medies në një mënyrë që të garantojë sigurinë e komunikimit, të minimizojë rrezikun e korruptimit të të dhënave dhe aksesit të paautorizuar, si dhe të ofrojë siguri në lidhje me burimin e informacionit të rregulluar.

Siguria e marrjes duhet të garantohet duke korrigjuar sa më shpejt të jetë e mundur çdo dështim ose ndërprerje në komunikimin e informacionit të rregulluar.

Emetuesi ose personi që ka aplikuar për pranim, për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, nuk do të jetë përgjegjës për gabimet sistemike ose mangësitë në medien të cilës i është komunikuar informacioni i rregulluar.

5. Informacioni i rregulluar duhet t'u komunikohet medieve në një mënyrë që e bën të qartë se informacioni është informacion i rregulluar, identifikon qartë emetuesin përkatës, objektin e informacionit të rregulluar dhe kohën e datën e komunikimit të informacionit nga emetuesi ose personi që ka aplikuar për pranim në tregtim në një treg të rregulluar pa pëlqimin e emetuesit.

Me kërkesë, emetuesi ose personi që ka aplikuar për pranim në tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, duhet të jetë në gjendje t'i komunikojë Autoritetit për çdo publikim në lidhje me informacionin e rregulluar, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e personit që ia ka komunikuar informacionin medies;

b) detajet e validimit të sigurisë;

c) orën dhe datën në të cilën informacioni iu komunikua medies;

ç) mjetin në të cilin u komunikua informacioni;

d) nëse është e aplikueshme, detajet e çdo embargoje të vendosur nga emetuesi për informacionin e rregulluar.

Neni 31

Bashkërendimi me sistemin evropian të aksesit

1. Aksesi në informacionin e rregulluar në nivel të Bashkimit Evropian sigurohet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me dispozitat e këtij ligji.

2. Rregullat për aksesin dhe transmetimin e informacionit përmes pikës evropiane të aksesit elektronik (ESAP) përcaktohen në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji.

Neni 32

Aksesi i informacionit përmes pikës evropiane të aksesit elektronik (ESAP)

1. Autoriteti siguron që kur publikohet informacioni i rregulluar, i parashikuar në pikën 1 të nenit 29 të këtij ligji, emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesën për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, e dorëzon atë informacion të rregulluar njëkohësisht te njësia që mbledh informacionin e përmendur në pikën 4 të këtij neni, me qëllim që informacioni të jetë i aksesueshëm në pikën e vetme evropiane të aksesit (ESAP), e krijuar sipas rregullores (BE) 2023/2859 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

2. Informacioni i rregulluar duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) të dorëzohet në një format të dhënash të ekstraktueshme, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 2 të rregullores (BE) 2023/2859 ose, kur kërkohet nga ligji i Bashkimit ose ligji kombëtar, në një format të lexueshëm nga makineria, siç përcaktohet në pikën 4 të nenit 2 të asaj rregulloreje;

b) të shoqërohet me të dhënat/metadatat e mëposhtme:

i. të gjithë emrat e personave fizikë ose juridikë, të cilëve u referohet informacioni;

ii. identifikuesi ligjor i subjektit (LEI), siç specifikohet në nenin 7(4), pika (b), të rregullores (BE) 2023/2859;

iii. madhësia e emetuesit, sipas kategorisë, siç specifikohet sipas nenit 7(4), pika (d), të rregullores (BE) 2023/2859;

iv. sektori/ët i/e industrisë së aktiviteteve ekonomike të emetuesit, siç specifikohet sipas nenit 7 (4), pika (e), të rregullores BE 2023/2859;

v. lloji i informacionit, siç klasifikohet sipas nenit 7(4), pika (c), të rregullores (BE) 2023/2859;

vi. një indikacion nëse informacioni përmban të dhëna personale.

3. Për qëllim të nënndarjes "ii" të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, emetuesit duhet të sigurojnë një kod identifikues të subjektit ligjor (LEI).

4. Për qëllim të bërjes të aksesueshëm në ESAP të informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, njësia që mbledh informacionin, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 2 të rregullores (BE) 2023/2859, do të jetë mekanizmi zyrtar i caktuar sipas pikës 2 të nenit 29 të këtij ligji.

5. Autoriteti siguron që informacioni i parashikuar në pikën 1 të nenit 42 të këtij ligji të bëhet i aksesueshëm në ESAP. Për këtë qëllim, njësia mbledhëse e informacionit, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 2 të rregullores të (BE) 2023/2859, do të jetë Autoriteti.

Neni 33

Aksesi në informacionin e rregulluar në nivel BE-je

Autoriteti harton rregulla në përputhje me rregulloren e deleguar (BE) 2016/1437 të Komisionit, bazuar në standardet teknike rregullatore të ESMA-së, të cilat përcaktojnë kërkesat teknike në lidhje me aksesin në informacionin e rregulluar në nivel BE-je për të specifikuar:

a) kërkesat teknike në lidhje me teknologjitë e komunikimit të përdorura nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji;

b) kërkesat teknike për vënien në funksion të pikës qendrore të aksesit për kërkimin e informacionit, të rregulluar në nivel BE-je;

c) kërkesat teknike në lidhje me përdorimin e një identifikuesi unik për çdo subjekt ligjor nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji;

ç) formatin standard për dorëzimin e informacionit të rregulluar nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji;

d) klasifikimin e përbashkët të informacionit të rregulluar nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji dhe listën e përbashkët të llojeve të informacionit të rregulluar.

Neni 34
Vendet e treta

1. Kur selia e regjistruar e emetuesit ndodhet në një vend të tretë për të cilin Republika e Shqipërisë është vendi i origjinës, Autoriteti mund ta përjashtojë këtë emetues nga kërkesat e neneve 4, 5, 6, 7, 8, 9, 13, pikat 6, 18, 21, 22, 23 dhe 24 të këtij ligji, me kusht që legjislacioni i vendit të tretë në fjalë të përcaktojë kërkesa ekuivalente me kërkesat e këtij ligji ose që ky emetues të përmbushë kërkesat e legjislacionit të një vendi të tretë që Autoriteti e konsideron si ekuivalent në përputhje me metodologjinë dhe kriteret e vlerësimit të ekuivalencës.

2. Autoriteti njofton ESMA-n për përjashtimin e dhënë sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni i mbuluar nga kërkesat e përcaktuara në vendin e tretë paraqitet në përputhje me nenin 27 të këtij ligji dhe publikohet në përputhje me parashikimet e neneve 28 dhe 29 të këtij ligji.

4. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, një emetues, selia e regjistruar e të cilit ndodhet në një vend të tretë, përjashtohet nga përgatitja e pasqyrave të tij financiare në përputhje me parashikimet e neneve 4 ose 5 të këtij ligji, me kusht që ky emetues t'i përgatisë pasqyrat e tij financiare në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtare të kontabilitetit, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, që merr në konsideratë nenin 9 të rregullores (KE) nr. 1606/2002.

5. Autoriteti, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës, siguron që informacioni i publikuar në një vend të tretë, që mund të jetë i rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë dhe publikun në BE, publikohet në përputhje me nenet 28 dhe 29 të këtij ligji, edhe nëse ky informacion nuk rregullohet sipas përkufizimit të informacionit të rregulluar, në kuptim të shkronjës "gj" të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji.

6. Sipërmarrjet që e kanë selinë e tyre të regjistruar në një vend të tretë, të cilat do të kishin kërkuar autorizim në përputhje me legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive ose sa i përket administrimit të portofolit sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, nëse do ta kishin selinë e regjistruar ose, vetëm në rastin e një shoqërie komisionere, selinë qendrore brenda Bashkimit Evropian, përjashtohen nga detyrimi për të agreguar zotërimet me zotërimet e sipërmarrjes mëmë sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 15, me kusht që ato të përmbushin kushte të barasvlershme të pavarësisë si shoqëri administruese ose shoqëri komisionere.

7. Për të siguruar kushte të njëtrajtshme të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian miraton masa zbatuese që përcaktojnë:

a) mekanizmin për vlerësimin e ekuivalencës së informacionit të kërkuar sipas këtij ligji, përfshirë pasqyrat financiare dhe informacionin e kërkuar, rregulloreve ose dispozitave administrative të një vendi të tretë;

b) deklarimin se për shkak të së drejtës së tij të brendshme, rregulloreve, dispozitave administrative ose praktikave apo procedurave, të bazuara në standardet ndërkombëtare të vendosura nga organizatat ndërkombëtare, vendi i tretë, ku është regjistruar emetuesi, siguron ekuivalencën e kërkesave të informacionit të parashikuara në këtë ligj.

8. Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian miraton masa që lidhen me vlerësimin e standardeve përkatëse për emetuesit e më shumë se një shteti.

9. Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian merr vendimet e nevojshme për ekuivalencën e standardeve të kontabilitetit dhe për ekuivalencën e standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë, siç parashikohet në legjislacionin kombëtar që transpozon nenin 29b të Direktivës 2013/34/BE.

10. Nëse Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian vendos se standardet e kontabilitetit ose standardet e raportimit të qëndrueshmërisë së një shteti të tretë nuk janë ekuivalente, ai mund t'u lejojë emetuesve përkatës të vazhdojnë përdorimin e këtyre standardeve gjatë një periudhe kalimtare të përshtatshme. Periudhat kalimtare dhe kushtet e përdorimit të standardeve joekuivalente përcaktohen me rregullore nga Autoriteti.

11. Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian miraton masa që synojnë vendosjen e kritereve të përgjithshme të ekuivalencës në lidhje me standardet e kontabilitetit dhe standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të rëndësishme për emetuesit e më shumë se një shteti.

12. Kriteret minimale që përdor Autoriteti për vlerësimin e ekuivalencës së standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë të emetuesve të vendeve të treta sigurojnë të paktën:

a) që sipërmarrjet të zbulojnë informacion për faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG);

b) zbulimin e informacionit të nevojshëm për të kuptuar ndikimet e sipërmarrjes për çështjet e qëndrueshmërisë dhe se si çështjet e qëndrueshmërisë ndikojnë në zhvillimin, ecurinë dhe pozicionin e saj.

Neni 35

Kërkesat ekuivalente

1. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 4 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi raporti vjetor i drejtimit të brendshëm kërkohet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) një analizë të drejtë të zhvillimit dhe performancës së biznesit të emetuesit dhe të pozicionit të tij, së bashku me një përshkrim të rreziqeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballet, në mënyrë të tillë që shqyrtimi të paraqesë një analizë të balancuar dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe performancës së biznesit të emetuesit dhe të pozicionit të tij, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit;

b) një indikacion të çdo ngjarjeje të rëndësishme që ka ndodhur nga fundi i vitit financiar;

c) indikacion të zhvillimit të mundshëm të ardhshëm të emetuesit.

Analiza e përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike, në masën e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, performancën ose pozicionin e emetuesit, duhet të përfshijë si treguesit financiarë, ashtu edhe, kur është e përshtatshme, treguesit jofinanciarë kryesorë të performancës që lidhen me biznesin e veçantë.

2. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 4 të nenit 5 të këtij ligji kur legjislacioni i tij kërkon përgatitjen e një seti të përmbledhur pasqyrash financiare së bashku me një raport të ndërmjetëm të menaxhimit, i cili përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) vlerësimin e periudhës së mbuluar;

b) treguesit mbi zhvillimin e mundshëm të ardhshëm të emetuesit për 6 muajt e mbetur të vitit financiar;

c) për emetuesit e aksioneve, transaksionet kryesore me palët e lidhura, nëse këto nuk janë bërë më parë publike në mënyrë të vazhdueshme.

3. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 4 dhe në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 5 të këtij ligji, kur sipas ligjit të atij vendi një person ose persona brenda emetuesit janë përgjegjës për informacionin financiar vjetor dhe 6-mujor dhe në veçanti për sa vijon:

a) përputhshmërinë e pasqyrave financiare me kuadrin e raportimit ose setin e standardeve të kontabilitetit në fuqi;

b) drejtësinë e vlerësimit/analizës së menaxhimit të përfshirë në raportin e drejtimit të brendshëm.

4. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi nuk kërkohet ofrimi i llogarive individuale nga kompania mëmë, por emetuesi, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet, në përgatitjen e llogarive të konsoliduara, të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) për emetuesit e aksioneve, llogaritjen e dividentëve dhe aftësinë për të paguar dividentë;

b) për të gjithë emetuesit, kur është e aplikueshme, kërkesat minimale të kapitalit dhe kapitalit dhe çështjet e likuiditetit.

Për qëllime të ekuivalencës, emetuesi duhet të jetë gjithashtu në gjendje t'i ofrojë Autoritetit deklarime shtesë të audituara, që japin informacion për llogaritë individuale të emetuesit si një të

vetme, relevante për elementet e informacionit, të përmendur në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike. Këto deklarime mund të përgatiten sipas standardeve të kontabilitetit të vendit të tretë.

5. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji për llogaritë individuale kur sipas ligjit të një vendi të tretë një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, nuk kërkohet të përgatisë llogari të konsoliduara, por kërkohet të përgatisë llogaritë e tij individuale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të njohura nga legjislacioni i fushës, që merr në konsideratë nenin 3 të rregullores (KE) nr. 1606/2002, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, siç zbatohet në Republikën e Shqipërisë dhe brenda Komunitetit Evropian ose me standardet kombëtare të kontabilitetit të vendeve të treta ekuivalente me ato standarde.

Për qëllime të ekuivalencës, nëse informacioni i tillë financiar nuk është në përputhje me ato standarde, ai duhet të paraqitet në formën e pasqyrave financiare të rishikuara. Për më tepër, llogaritë individuale duhet të auditohen në mënyrë të pavarur.

6. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 6 të nenit 15 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi periudha kohore brenda së cilës një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, duhet të njoftohet për zotërimet kryesore dhe brenda së cilës duhet t'ia zbulojë publikut këto zotërime kryesore është në total jo më shumë se 7 ditë tregtimi. Afatet kohore për njoftimin e emetuesit dhe për publikimin e mëtejshëm te publiku nga emetuesi mund të jenë të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të nenit 15 dhe pikën 6, të nenit 15 të këtij ligji.

7. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) në rastin e një emetuesi, të cilit i lejohet të mbajë deri në një maksimum prej 5% të aksioneve të veta, me të cilat janë të bashkëngjitura të drejtat e votës, ai duhet të bëjë një njoftim sa herë që arrihet ose tejkalohet ky prag;

b) në rastin e një emetuesi, të cilit i lejohet të mbajë deri në një maksimum prej 5% dhe 10% të aksioneve të veta, me të cilat janë të bashkëngjitura të drejtat e votës, ai duhet të bëjë një njoftim sa herë që arrihet ose tejkalohet një prag prej 5% ose ai prag maksimal;

c) në rastin e një emetuesi, të cilit i lejohet të mbajë më shumë se 10% të aksioneve të veta, të cilave u bashkëngjiten të drejtat e votës, ai duhet të bëjë njoftim sa herë arrihet ose tejkalohet pragu prej 5% ose pragu prej 10%.

Për qëllime të ekuivalencës, nuk kërkohet njoftim mbi pragun prej 10%.

8. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi,një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet t'i zbulojë publikut numrin e përgjithshëm të të drejtave të votës dhe kapitalin brenda 30 ditëve kalendarike pasi të ketë ndodhur një rritje ose ulje e këtij numri të përgjithshëm.

9. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenet 25, pika 2, dhe 26, pika 2, të këtij ligji, për sa i përket përmbajtjes së informacionit në lidhje me mbledhjet, kur, sipas ligjit të atij vendi, një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet të ofrojë të paktën informacion për vendin, kohën dhe rendin e ditës së mbledhjeve.

10. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kushte pavarësie ekuivalente me ato të përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 15 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi një shoqëri administruese ose shoqëri komisionere kërkohet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të jetë e lirë në të gjitha situatat për të ushtruar në mënyrë të pavarur nga shoqëria e saj mëmë të drejtat e votës të lidhura me asetet që ajo administron;

b) shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të mos konsiderojë interesat e shoqërisë mëmë ose të çdo shoqërie tjetër të kontrolluar të shoqërisë mëmë sa herë që lindin konflikte interesi.

Shoqëria mëmë duhet të përmbushë kërkesat e njoftimit të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 18 të këtij ligji.

Përveç kësaj, ajo duhet të bëjë një deklaratë se në rastin e secilës shoqëri administrimi ose shoqërie komisionere në fjalë shoqëria mëmë i përmbush kushtet e përcaktuara në këtë paragraf.

11. Pa cenuar zbatimin e nenit 36 të këtij ligji, shoqëria mëmë duhet të jetë në gjendje që me kërkesë të Autoritetit t'i provojë këtij të fundit, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës së emetuesit, se janë respektuar kërkesat e përcaktuara në pikën 4 të nenit 18 të këtij ligji.

KREU IV
KOMPETENCAT E AUTORITETIT

Neni 36
Autoritetet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre

1. Autoriteti është autoriteti kompetent për zbatimin e kërkesave të këtij ligji.

2. Me qëllim kryerjen e funksioneve të tij, Autoriteti ka kompetencën:

a) t'u kërkojë audituesve, emetuesve, zotëruesve të aksioneve ose instrumenteve të tjera financiare apo personave ose subjekteve, të përmendura në nenet 13, 14, 15 dhe 20 të këtij ligji, dhe personave që i kontrollojnë ose kontrollohen prej tyre sigurimin e informacioneve dhe dokumenteve;

b) t'i kërkojë emetuesit të publikojë informacionin e kërkuar sipas shkronjës "a" të kësaj pike me anë të mjeteve dhe brenda afateve kohore që Autoriteti konsideron të nevojshme. Ai mund ta publikojë këtë informacion me iniciativën e tij në rastet kur emetuesi ose personat që e kontrollojnë ose kontrollohen nga ai nuk arrijnë ta bëjnë këtë dhe pasi ka dëgjuar emetuesin;

c) t'u kërkojë drejtuesve të emetuesve dhe të zotëruesve të aksioneve ose instrumenteve të tjera financiare apo të personave ose subjekteve, të përmendura në nenet 13, 14, 15 dhe 20 të këtij ligji, të përcjellin informacionin e kërkuar dhe, nëse është e nevojshme, të sigurojnë informacione dhe/ose dokumente shtesë;

ç) të pezullojë ose t'i kërkojë tregut të rregulluar përkatës të pezullojë tregtimin e titujve për një maksimum prej dhjetë ditësh të njëpasnjëshme, nëse ka arsye që të dyshojë se dispozitat e këtij ligji janë shkelur nga emetuesi;

d) të ndalojë tregtimin në një treg të rregulluar nëse konstaton ose nëse ka arsye që të dyshojë se janë shkelur dispozitat e këtij ligji;

dh) të monitorojë që emetuesi publikon në kohë informacionet, me qëllim garantimin e aksesit efikas dhe të barabartë të publikut në të gjitha shtetet anëtare, ku tregtohen titujt dhe, në rast të kundërt, të marrë masat e duhura;

e) të bëjë publik faktin që një emetues, zotërues aksionesh apo instrumentesh të tjera financiare, ose një person apo subjekt, i parashikuar në nenet 13 deri në 15 të këtij ligji, nuk po përmbush detyrimet e tij;

ë) të verifikojë që informacioni i përmendur në këtë ligj është hartuar në përputhje me kuadrin përkatës të raportimit dhe të marrë masat e duhura në rast të konstatimit të shkeljeve;

f) të kryejë inspektime në vend në territorin e tij, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me dispozitat e këtij ligji dhe masat e tij zbatuese.

3. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, Autoriteti në çdo rast mund t'u drejtohet organeve gjyqësore në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

4. Autoriteti ushtron kompetencat e tij të përcaktuara në këtë nen në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) drejtpërdrejt;

b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;

c) me delegim tek autoritete të tjera, nën përgjegjësinë e tij;

ç) me kërkesë të autoriteteve gjyqësore kompetente.

5. Pikat 1 deri në 4 të këtij neni nuk e cenojnë mundësinë që një shtet anëtar të bëjë rregullime të veçanta ligjore dhe administrative për territoret evropiane jashtë vendit për të cilat marrëdhëniet e jashtme janë përgjegjësi e atij shteti anëtar.

6. Dhënia e informacionit Autoritetit nga audituesit për ndonjë fakt ose vendim në lidhje me kërkesa të bëra nga Autoriteti, sipas shkronjës "a", të pikës 2 të këtij neni, nuk do të përbëjë shkelje

të ndonjë kufizimi për dhënien e informacionit të vendosur nga kontrata ose nga ndonjë ligj, rregullore apo dispozitë administrative dhe nuk do t'i bëjë këta auditues të përgjegjshëm në ndonjë formë.

Neni 37

Sekreti profesional dhe bashkëpunimi midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare

1. Personat që punojnë ose kanë punuar për Autoritetin, si dhe entitete tek të cilët Autoriteti mund të ketë deleguar detyra të caktuara janë subjekt i detyrimit të sekretit profesional. Informacioni konfidencial i marrë në këtë mënyrë nuk mund të zbulohet ndaj asnjë personi apo autoriteti tjetër, përveç rasteve të përcaktuara në ligj, rregullore apo dispozita administrative

2. Autoriteti bashkëpunon me autoritetet kompetente të shteteve anëtare sa herë që është e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave të tij dhe ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj. Autoriteti u jep mbështetje/asistencë autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare.

3. Gjatë ushtrimit të kompetencave hetimore dhe sanksionuese, Autoriteti bashkëpunon me autoritetet kompetente të shteteve anëtare për të siguruar që sanksionet dhe masat japin rezultatet e dëshiruara dhe koordinojnë veprimet e tyre kur trajtojnë raste ndërkufitare.

4. Autoriteti dhe autoritetet e tjera kompetente mund t'i drejtohen ESMA-s në rastet kur një kërkesë për bashkëpunim është refuzuar ose nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, sipas kompetencave të përcaktuara me rregulloren (BE) nr. 1095/2010. Pa paragjykuar nenin 258 të Traktatit për Funksionimin e BE-së, ESMA mund të veprojë sipas kompetencave të saj të dhëna në nenin 19 të rregullores (BE) nr. 1095/2010.

5. Autoriteti bashkëpunon me ESMA-n për qëllim të këtij ligji në përputhje me rregulloren (BE) nr. 1095/2010.

6. Autoriteti i jep pa vonesë ESMA-s të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj, sipas këtij ligji dhe rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni nuk e pengon Autoritetin të shkëmbejë apo të përcjellë informacion konfidencial tek autoritetet e tjera kompetente, tek ESMA dhe te Bordi Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB). Çdo informacion i shkëmbyer në këtë mënyrë mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional, subjekt i të cilit janë punonjësit aktualë apo ish-punonjësit e autoriteteve kompetente që marrin informacionin.

8. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente ose organet e vendeve të treta, të mundësuara në bazë të legjislacionit të tyre përkatës, për përmbushjen e çdo detyre, sipas këtij ligji, në përputhje me parashikimet e nenit 36 të këtij ligji. Shkëmbimi i informacioni kryhet me qëllim përmbushjen e funksioneve mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente apo organeve të përmendura dhe është subjekt i garantimit të sekretit profesional, të paktën i barasvlershëm me atë që përmendet në këtë nen, kur:

a) lidh marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente ose organet e vendeve të treta, Autoriteti njofton ESMA-n;

b) informacioni buron nga një shtet anëtar tjetër, ai nuk mund të zbulohet pa dakordësinë e shprehur të autoriteteve kompetente që e kanë zbuluar atë dhe, kur është e përshtatshme, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë dakordësinë e tyre.

Neni 38

Masat paraprake

1. Kur Autoriteti, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit pritës, zbulon se një emetues ose mbajtësi i aksioneve apo i instrumenteve të tjera financiare të tij, ose një person apo entitet, i përmendur në nenin 13 të këtij ligji, ka kryer parregullsi ose ka shkelur detyrimet, ai i referon gjetjet tek autoriteti kompetent përkatës i shtetit anëtar të origjinës dhe tek ESMA.

2. Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoriteti kompetent i vendit anëtar të origjinës ose për shkak se këto masa rezultojnë të pamjaftueshme, emetuesi ose mbajtësi i titujve vijon të shkelë

dispozitat ligjore apo rregullatore përkatëse, Autoriteti, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit pritës, pasi informon autoritetin kompetent të shtetit të origjinës, merr të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e investitorëve dhe informon Komisionin Evropian dhe ESMA-n sa më shpejt të jetë e mundur.

KREU V
SHKELJET E DISPOZITAVE

Neni 39
Masat mbikëqyrëse dhe sanksionet

1. Në rast të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji, Autoriteti vendos masa mbikëqyrëse dhe sanksione si më poshtë:

a) publikon një deklaratë që identifikon personin fizik ose juridik përgjegjës dhe natyrën e shkeljes;

b) urdhëron personin fizik ose juridik përgjegjës të korrigjojë shkeljen brenda një afati të caktuar dhe të mos e përsërisë më atë;

c) vendos sanksion me gjobë.

2. Masat administrative dhe sanksionet sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese.

3. Pa cenuar parashikimet e nenit 9 të këtij ligji, kur detyrimet e parashikuara në këtë ligj u ngarkohen personave juridikë, Autoriteti siguron që në rast shkeljeje sanksionet dhe masat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë ligj të mund të zbatohen ndaj anëtarëve të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të personit juridik, si dhe ndaj personave të tjerë fizikë përgjegjës për shkeljen, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Pa cenuar kompetencat e Autoritetit të parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe zbatimin e dispozitave penale sipas legjislacionit në fuqi, Autoriteti mund të pezullojë ushtrimin e së drejtës së votës që lidhet me aksionet në rastin e shkeljeve të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji, kur këto shkelje vlerësohen si të rënda.

Neni 40
Sanksionet me gjobë

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 500 000 lekë deri në 4 000 000 lekë ndaj subjektit juridik nëse:

a) në kundërshtim me nenin 4 të këtij ligji, nuk publikon raportin financiar vjetor brenda afatit ligjor dhe/ose nuk e paraqet atë pranë Autoritetit, si dhe nuk siguron që raporti financiar vjetor të mbetet i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet;

b) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji, raporti financiar vjetor nuk përmban informacionin e kërkuar nga ky nen;

c) në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji, nuk publikon raportin financiar 6-mujor brenda afatit ligjor dhe/ose nuk e paraqet atë pranë Autoritetit, si dhe nuk siguron që raporti financiar 6-mujor të mbetet i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet;

ç) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji, raporti financiar 6-mujor nuk përmban informacionin e kërkuar;

d) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 12 të këtij ligji, nuk njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës që zotëron, kur si rezultat i blerjes ose shitjes së aksioneve kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie nën pragjet prej 5%, 10%, 15%, 20%, 25%, 30%, 50% dhe 75% për aksionet e një emetuesi, titujt e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

dh) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji, nuk njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës që zotëron kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie nën pragjet prej 5%, 10%, 15%,

20%, 25%, 30%, 50% dhe 75%, si rezultat i ngjarjeve që ndryshojnë përbërjen e të drejtave të votës ose numrin e të drejtave të votës të lidhura me aksionet;

e) në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji, nuk përgatit raportin për pagesat që bëhen ndaj institucioneve shtetërore, kur ushtron veprimtari në industrinë nxjerrëse ose në industrinë primare të prerjes së pyjeve;

ë) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 8 të këtij ligji, nuk e bën publik raportin për pagesat që bëhen ndaj institucioneve shtetërore brenda afatit ligjor dhe nuk siguron që ai të mbetet i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet;

f) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 11 të këtij ligji, nuk njofton Autoritetin se vepron ose synon të veprojë si krijues tregu për një emetues të caktuar brenda afatit ligjor, si dhe nuk zbaton detyrimet sipas nenit 13 të këtij ligji.

g) në kundërshtim me pikën 3, të nenit 11 të këtij ligji, me kërkesë të Autoritetit, nuk vë në dispozicion marrëveshjen e krijimit të tregut të lidhur me operatorin e tregut dhe/ose emetuesin;

gj) në kundërshtim me nenet 20 dhe 21 të këtij ligji, nuk njofton Autoritetin;

h) në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji, nuk publikon informacionin për ndryshimet dhe numrin e ri total të aksioneve me të drejta vote brenda afatit të parashikuar;

i) në kundërshtim me pikën 6, të nenit 15 të këtij ligji, nuk bën publik brenda afatit ligjor informacionin e përfshirë në njoftimin e marrë për zotërimet e mëdha ose pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital;

j) në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji, nuk paraqet pranë Autoritetit informacionin e rregulluar të paraqitur pranë emetuesit;

k) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 18 të këtij ligji, nuk paraqet pranë Autoritetit listën e shoqërive administruese dhe/ose shoqërive komisionere së bashku me deklaratën për përmbushjen e kushteve të pavarësisë;

l) në kundërshtim me pikën 3 të nenit 18 të këtij ligji, nuk përditëson në mënyrë të vazhdueshme listën e përmendur në këtë nen;

ll) në kundërshtim me nenin 22 të këtij ligji, në rast të blerjes ose shitjes së aksioneve të veta, nuk bën publik përqindjen e aksioneve të veta brenda afatit ligjor;

m) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk publikon informacionin për vendin, kohën dhe rendin e ditës së mbledhjeve të aksionarëve;

n) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk vë në dispozicion formularin e prokurës për aksionarët;

nj) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk cakton një institucion financiar si agjent për ushtrimin e të drejtave financiare të aksionarëve;

o) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk publikon njoftime lidhur me dividendët dhe emetimin e aksioneve të reja;

p) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 26 të këtij ligji, nuk siguron trajtim të barabartë për zotëruesit e titujve të borxhit që renditen *pari passu*;

q) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji, nuk publikon informacionin e kërkuar për mbledhjet dhe të drejtat e zotëruesve të titujve të borxhit;

r) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji, nuk vë në dispozicion formularin e prokurës për zotëruesit e titujve të borxhit;

rr) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 26 këtij ligji, nuk cakton një institucion financiar si agjent për ushtrimin e të drejtave financiare të zotëruesve të titujve të borxhit;

s) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 29 të këtij ligji, nuk i paraqet Autoritetit informacionin e rregulluar për publikim;

sh) në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji, nuk e paraqet informacionin e rregulluar në gjuhën shqipe kur titujt janë pranuar për tregtim vetëm në Republikën e Shqipërisë;

t) në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji, nuk bën publik pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat që lidhen me aksionet ose instrumentet derivative që japin të drejtë për akses në aksione;

th) në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji, nuk publikon informacionin e rregulluar në mënyrë që të sigurojë akses të shpejtë, të barabartë dhe jodiskriminues dhe nuk e vë atë në dispozicion të mekanizmit qendror të ruajtjes së informacionit.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, në rastet e shkeljeve shumë të rënda, të cilat cenojnë ose rrezikojnë seriozisht integritetin e tregut financiar, shkaktojnë çrregullim të rëndë të tregut ose kanë sjellë përfitime të konsiderueshme materiale, duke cenuar mbrojtjen e investitorëve, transparencën e tregut ose funksionimin e rregullt të tij, Autoriteti mund të vendosë, në mënyrë të arsyetuar, sanksion me gjobë:

a) 100 000 000 lekë ose deri në 5% të totalit të xhiros vjetore, sipas pasqyrave financiare më të fundit të disponueshme të miratuara nga organi drejtues apo të xhiros vjetore, sipas pasqyrave të konsoliduara të miratuara nga organi drejtues i shoqërisë mëmë; ose

b) deri në dyfishin e shumës së fitimeve të nxjerra ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, kur këto mund të përcaktohen, cilado qoftë shuma më e madhe, sipas shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike.

3. Për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë ndaj personit fizik apo personit përgjegjës të subjektit.

4. Pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, në rastet e shkeljeve shumë të rënda, të cilat cenojnë ose rrezikojnë seriozisht integritetin e tregut financiar, shkaktojnë çrregullim të rëndë të tregut ose kanë sjellë përfitime të konsiderueshme materiale, duke cenuar mbrojtjen e investitorëve, transparencën e tregut ose funksionimin e rregullt të tij, Autoriteti mund të vendosë, në mënyrë të arsyetuar, sanksion me gjobë:

a) 20 000 000 lekë; ose

b) deri në dyfishin e shumës së fitimeve të nxjerra ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, kur këto mund të përcaktohen, cilado qoftë shuma më e madhe, sipas shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike.

Neni 41

Kriteret për vendosjen e sanksioneve administrative

1. Në përcaktimin e llojit dhe nivelit të sanksioneve administrative, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse duke përfshirë, sipas rastit:

a) shkallën dhe kohëzgjatjen e shkeljes;

b) shkallën e përgjegjësisë së personit fizik ose subjektit juridik përgjegjës;

c) situatën financiare të personit fizik ose juridik përgjegjës, të treguar nga xhiroja vjetore totale e subjektit juridik përgjegjës ose nga të ardhurat vjetore të personit fizik përgjegjës;

ç) rëndësinë e të ardhurave të fituara ose të humbjeve të shmangura nga personi fizik ose juridik përgjegjës, nëse ato mund të përcaktohen;

d) humbjet që u janë shkaktuar palëve të treta nga shkeljet, nëse ato mund të përcaktohen;

dh) nivelin e bashkëpunimit të personit fizik ose subjektit juridik përgjegjës me autoritetin;

e) shkeljet e mëparshme nga personi fizik ose subjekti juridik përgjegjës.

2. Përpunimi i të dhënave personale, të marra me qëllim ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse dhe hetimore administrative, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 42

Publikimi i vendimeve

1. Autoriteti publikon pa vonesë në faqen zyrtare të internetit çdo vendim për sanksionet administrative të vendosura për shkelje të këtij ligji, duke përfshirë të paktën informacionin për llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personave fizikë ose juridikë përgjegjës për shkeljen.

Autoriteti mund të shtyjë publikimin e vendimit ose të vendosë publikimin e tij në formë anonime kur konstaton se ekziston të paktën një nga rrethanat e mëposhtme:

a) në rast se sanksioni vendoset ndaj një personi fizik dhe publikimi i të dhënave personale rezulton të jetë joproporcional ose cenues, bazuar në një vlerësim paraprak të detyrueshëm të proporcionalitetit;

b) publikimi do të rrezikonte seriozisht stabilitetin e sistemit financiar ose një hetim në vazhdim;

c) publikimi, për aq sa mund të përcaktohet, do të shkaktonte dëme joproporcionale dhe serioze për institucionet ose personat fizikë të përfshirë.

2. Nëse apelohet kundër vendimit të publikuar, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Autoriteti ose duhet të përfshijë informacion në lidhje me këtë në publikim në kohën e publikimit, ose ta ndryshojë publikimin nëse apelimi ndërmerret pas publikimit fillestar.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 43
Aktet nënligjore

Autoriteti miraton rregulloret në zbatim të këtij ligji brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi e tij.

Neni 44
Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e këtij ligji, të cilat lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e mekanizmave dhe infrastrukturës së Bashkimit Evropian, zbatohen plotësisht nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian si më poshtë:

a) neni 31;

b) pikat 1, 4 dhe 5, të nenit 32;

c) neni 33;

ç) pikat 4, 5, 6, 7 dhe shkronja “a” e pikës 8 të nenit 37;

d) çdo dispozitë tjetër e këtij ligji, që parashikon detyrime për Autoritetin në lidhje me njoftimet ose raportimet drejtuar Autoritetit Evropian të Tregjeve të Titujve (ESMA); bashkimin, ndërveprimin ose integrimin e mekanizmit zyrtar të ruajtjes qendrore të informacionit të rregulluar me pikën e vetme evropiane të aksesit (ESAP); zbatimin e drejtpërdrejtë të procedurave të përcaktuara nga Komisioni Evropian për nivelin e Bashkimit Evropian.

2. Dispozitat që lidhen me ESMA-n, njoftimin e saj dhe mekanizmat në nivel BE-je të ekuivalencës, sipas nenit 34 të këtij ligji, do të zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

3. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, të gjitha detyrimet e emetuesve dhe personave të tjerë, sipas parashikimeve të këtij ligji, përfshirë kërkesat për publikim dhe depozitimin e informacionit të rregulluar në mekanizmin zyrtar të ruajtjes qendrore, zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 45
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Bordi i Autoritetit shfuqizon rregulloren “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”, miratuar me vendimin nr. 5, datë 26.1.2023.

Neni 46
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç dispozitave të parashikuara në nenin 44 të këtij ligji, të cilat fillojnë efektet juridike pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 458, datë 30.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.